



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program



Zhvillimi i Shkathësive të Shekullit 21 në lëndën e GJUHËS ANGLEZE



Aa /eɪ/ Xx
Ss /s/ Dd /di/ /di/ /di/
Yy /waɪ/ Cc /si/ /si/
Ee /i/ Uu /ju/ Ff /ɛf/
Vv /vi/ /zɛd/ /zɛd/
Bb /bi/ Zz

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Doracaku është financuar nga populli amerikan përmes Agjensionit të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për arsimin themelor (Basic Education Program të USAID-it) të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën Arsimore të Kosovës (KEC).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

Zhvillimi i Shkathtësive të Shekullit 21 në lëndën e **GJUHËS ANGLEZE**

HARTUAR NGA

Stephen Luke

Xhavit Rexhaj

Jehona Xhaferi

Shykrane Gërmizaj

Petrit Tahiri

REDAKTIMI

Florina Salihu

DIZAJNI GRAFIK

indesign

BOTIMI I PARË

Tetor, 2012

FALENDERIME:

Basic Education Program (Programi i Arsimit Themelor) u shprehë falenderime të sinqerta të gjithë atyre që kontribuan në realizimin e këtij doracaku. Po ashtu u jemi mirënjohës zonjave Flaurie Storie dhe Bora Shpuza-Kasapolli për këshillat dhe ndihmën e tyre profesionale e gjuhësore. Veçanërisht i jemi mirënjohës Znj. Amy Schirmer, eksperte e gjuhë sangleze, për leximin e redaktimin e kujdesshëm, pastaj mësimdhënësve në vijim: Ardita Hima, Fitore Hoxha, Arlinda Zeqiri, Makfire Vokrri dhe Z. Alush Kryeziu të cilët në mënyra të ndryshme kanë kontribuar në hartimin dhe finalizimin e këtij doracaku.

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| 1. Mirësevini | 6 |
| 2. Tabela e shkurtesave | 7 |
| 3. Si mund të ju ndihmojë doracaku? | 8 |
| 4. Si ta përdorim doracakun? | 9 |
| 4.1 Legjenda | 9 |
| 5. Përse disa fëmijëve shkolla ju duket e mërzitshme? | 12 |
| 5.1 Teknologjia informative për zhvillim personal profesional | 13 |
| 5.2 Rëndësia e internetit | 13 |
| 6. Mjetet relevante mësimore | 14 |
| 6.1 Librat | 14 |
| 6.2 Qasjet e reja mund të zhvillohen me materiale nga përditshmëria | 15 |
| 6.3 ... dhe materiale alternative | 15 |
| 6.4 ... përgjigjja jonë... përdorimi i teknologjisë | 16 |
| 7. Çka të mësojmë? | 18 |
| 7.1 Përcaktimi i qëllimeve dhe rezultateve mësimore | 18 |
| 8. Si të mësojmë? | 19 |
| 8.1 Këndvështrimi i mësimdhënësve | 19 |
| 8.2 Reagimi ndaj ndryshimeve marramendëse | 19 |
| 8.3 Misioni i ri në rrethanat e ndryshuara | 19 |
| 8.4 ... çfarë mësimdhënie? | 20 |
| 8.5 ... qasjet bashkëkohore | 20 |
| 9. Shembuj të qasjeve të reja për përvoja të papërsëritshme të të nxënësve | 22 |
| 9.1 Mësimi i Gjuhës Angleze me Ndihmën e Kompjuterit(MGJNK) | 22 |
| 9.2 Qasjet komunikuese dhe të nxënësve të bazuar në detyra | 27 |
| 10. A ju pengon që nxënësit kalojnë shumë kohë në internet? | 37 |
| 10.1 Komunitetet e të nxënësve - disa nga rrjetet sociale | 37 |
| 10.2 Dhënia dhe pranimi i komenteve efektive: Udhërrëfyes për vetëvlerësimin përmes kolegëve | 47 |
| 10.3 Vlerësimi për të nxënësve (vlerësimi formativ) dhe vlerësimi i të nxënësve (vlerësimi sumativ) | 51 |
| 10.4 Përkufizime për vlerësimin dhe llojet e vlerësimit | 53 |
| 10.5 Përzgjedhje e faqeve të dobishme në internet | 54 |
| 11. Qasja komunikative në të nxënësve të gjuhës angleze | 58 |
| 12.1 Portofolioja e mësimdhënësve | 63 |
| 13. Lista e referencave | 66 |
| eResources on various topics and English speaking cultures - can be used in making learning more attractive | 63 |

1. Mirësevini

Ky doracak i dedikohet mësimit të gjuhës angleze dhe edukatorëve tjerë që e aplikojnë përdorimin e teknologjisë informative.

Mësimdhënia e gjuhës angleze ka qenë e kufizuar për shkak të mungesës së pajisjeve praktike. Për të qenë i shkëlqyeshëm në një gjuhë të huaj, nxënësit duhet të kenë mundësi ta praktikojnë atë në kontekstin real. Shumica e fëmijëve (dhe të rriturve) mësojnë më lehtë nëse kanë mundësi që praktikisht ta zhvillojnë një aktivitet. Një proverbë kineze e paraqet këtë shumë thjeshtë:

Unë dëgjoj ... Unë harroj

Unë shoh ... Unë mbaj mend

Unë bëj ... Unë kuptoj

Disa shkolla në Kosovë tashmë e kanë prezantuar qasjen e re që paraqitet në këtë doracak. Këto shkolla janë të pajisura me pajisje adekuate që ju mundëson qasjen praktike të mësimdhënies.

Ky doracak ka për qëllim që të ju ndihmojë ti zhvillonin njohuritë tuaja dhe të kuptuarit e qasjes praktike të gjuhës angleze dhe përdorimin e teknologjisë informative. Shpresojmë se do të ju ndihmojë gjatë orëve të mësimi. Doracaku do të paraqesë shembuj praktikë të aktiviteteve.

Doracaku do të ju njoftojë me strategji të reja. Këto strategji përfshijnë: ti bëjmë qëllimet e orës së mësimi të qarta tek nxënësit, të ofrojmë kriteret e qarta për sukses, ta zhvillojmë të menduarit kreativ, të zgjedhim sfidat e dizajnit, punën grupore dhe të komunikuarit efektiv, mbështetjen tek miku, shembuj konkretë, kritikizem konstruktiv, dhe poashtu vlerësimin dhe planifikimin e të nxënësve. Arsyeja kryesore pse kjo qasje është më efektive është sepse ndihmon nxënësit të zhvillojnë të kuptuarit.

Ky doracak shërben si vegël për të ndihmuar të nxënësve më të shpejtë të gjuhës angleze dhe poashtu ju ndihmon të gjeni informata të ndryshme shumë me shpejtë përmes përdorimit të teknologjisë informative.



2. Tabela e shkurtesave

| | |
|----------------|--|
| MASHT | Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë |
| USAID | Agjensioni i SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar |
| FHI 360 | Family Health International |
| BEP | Basic Education Program |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| TIK | Teknologjia Informativë dhe e Komunikimit |
| KKK | Korniza e Kurrikulës së Kosovës |



3. Si mund të ju ndihmojë doracaku?



Qëllimi kryesor i doracakut është të shërbejë si burim informacionesh dhe të ndihmojë mësime të aplikojnë Teknologjinë Informativë për përmirësimin e mësimit dhe të nxënies të Gjuhës Angleze në shkollat e Kosovës. Ne synojmë ta bëjmë këtë duke treguar mënyrat se si teknologjia informative mund të përdoret për lehtësimin e të nxënies të Gjuhës Angleze.

Ne e dimë se teknologjia informative ende nuk është duke u përdorur me kapacitet maksimal për të mbështetur mësime dhe të nxënies në shkollë (dhe në shtëpi). Në anën tjetër, shkollat tona janë duke i rritur mundësitë e qasjes në teknologji informative dhe interneti po bëhet pjesë e pothuaj se çdo familje në Kosovë.

Ky doracak ju ndihmon të mësoni se si ta përdorni teknologjinë informative dhe të komunikimit (TIK) në mësime dhe nxënies të gjuhës angleze. Doracaku do të ju informojë edhe për përparësitë që sjell përdorimi i teknologjisë informative. Kjo do të ndihmojë në mënyre direkte që:


- Të zhvillohen shkathtësitë e mësimeve, dhe me këtë edhe të nxëniesve, në dy lëmi kryesore: në mësime dhe gjuhës angleze dhe përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit (TIK)
- Të mundësohet integrimi më i lehtë në shoqëri dhe në tregun e punës në Kosovë, Evropë dhe më gjerë.

Doracaku ofron:

- Metodën dhe strategjinë më të reja të mësimeve të gjuhës angleze si gjuhë e huaj duke u bazuar në kurrikulën e re;
- Metodën dhe strategjinë më të reja të mësimeve të gjuhës angleze si gjuhë e huaj duke u bazuar në kurrikulën e re;
- Shkathtësi për përdorimin e flip-kamerës për zhvillim profesional dhe personal, dhe për ta përmirësuar mësime;
- Qasje dhe shkathtësi për të përdorur teknologjinë dhe burimet në internet;
- Informata se si: Facebook, Twitter, MySpace, etj. mund të përdoren për të përmirësuar gjuhën angleze;



4. Si ta përdorim doracakun?



Ky doracak prezanton qasje të reja në mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës angleze, përfshirë edhe disa praktika të mira të provuara nga mësimdhënësit tanë gjatë hartimit të kursit për

“Përdorimin e teknologjisë në mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës angleze”.

Në fillim të këtij doracaku, pra në katër kapitujt e parë, do të gjeni informata lidhur me atë se çka është qëllimi i këtij doracaku, nevoja e përdorimit të TIK-ut gjatë mësimdhënies së gjuhës angleze, pse mendojmë se ky doracak do të ju ndihmojë dhe si ta përdorim doracakun.

Kapitulli i pestë përshkruan kompetencat relevante të shekullit 21 dhe veglat relevante të të nxënit.

Kapitulli i gjashtë na jep shembuj të qasjeve të reja dhe përvojave të reja: si të reagojmë ndaj ndryshimeve, si mund të mësojmë përmes ushtrimeve, pse është të nxënit vizuel/digjital i rëndësishëm dhe si reflektohet e gjithë kjo tek nxënësit.






Kapitulli i shtatë flet mbi internetin dhe sa kohë kalojmë në internet, si mund ta kthejmë këtë kohë në kohë efektive, cilat janë burimet më të mira të internetit që mund të përdorim, këshilla se si ti përdorim mediat sociale (nga gjuha angleze: “social media”) për të komunikuar në shkollë. Ky kapitull poashtu shpjegon vlerësimin formativ, dhe ju referon në uebfaqe të dedikuara për mësimdhënës.

Kapitulli i tetë përmban shembuj te portfolios se mësimdhënësit, listen e referencave dhe eResurset (apo burimet nga interneti) ne lidhje me temat e ndryshme dhe kulturat e ndryshme angleze.

Kapitulli i nëntë mbulon shembuj të qasjeve të reja, kapitulli i dhjetë flet mbi vlerësimin, kapitulli i njëmbëdhjetë përmban portofolion e mësimdhënësit.

Ndërsa në fund e kemi listën e referencave dhe burimeve të informatave në internet lidhur me të nxënit e gjuhës angleze.

4.1 Legjenda

| | |
|---|--|
|  | Shembuj konkret apo tregime nga shkolla |
|  | Aktivitetet në klasë |
|  | Më rëndësi të madhe |
|  | Vegëzat e ndryshme p.sh. shiko fq x, referim në uebfaqe, etj.  |

SHKATHËSITË

Basic Education Program

Përmes punës në grupe, nxënësit zhvillojnë shkathësitë e komunikimit, kreativitetin dhe e pranojnë mendimin e njëri tjetrit. Gjatë punës në grupe ata kuptojnë rolet e tyre në grup. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin përmes aktiviteteve konkrete.



të menduarit kritik



vetëvlerësimi



puna grupore



udhëheqësia

KOMPETENCAT KRYESORE TË KURRIKULËS SË KOSOVËS

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT
(Komunikues efektiv)

KOMPETENCA E TË MENDUARIT (Mendimtar kreativ)

KOMPETENCA E TË MËSUARIT (Nxënës i suksesshëm)

KOMPETENCA QË KA TË BËJË ME PUNËN, JETËN DHE MJEDISIN
(Kontribues Produktiv)

KOMPETENCA PERSONALE (Individ i shëndoshë)

KOMPETENCA QYTETARE (Qytetar i përgjegjshëm)



të lexuarit

E SHEKULLIT 21

Ata do të zhvillojnë ndërmarrësi, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit 21 do t'u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.

SHKATHTËSITË RELEVANTE TË BASIC EDUCATION PROGRAM

LEGJENDA

- të menduarit kritik
- vetëvlerësimi
- puna grupore
- të lexuarit
- TIK-u
- të zgjidhurit e problemit
- kreativiteti
- hulumtimi
- ndërmarrësia
- udhëheqësia
- gjuha e huaj



TIK-u



të zgjidhurit e problemit



kreativiteti



ndërmarrësia



gjuha e huaj



hulumtimi

5. Përse disa fëmijëve shkolla ju duket e mërzitshme?



Një çështje tjetër jashtëzakonisht e rëndësishme ka të bëjë me **nxënësit**. Fëmijët sot duket të jenë shumë përpara mësimdhënësve dhe shkollës së tyre në të kuptuarit dhe përdorimin e TIK-ut në jetën e përditshme, por edhe në të nxënit e gjuhëve. Kjo shihet nga fakti që shumica e fëmijëve e flasin anglishten relativisht mirë edhe në zonat më të largëta ku ka mungesë të theksuar të mësimdhënësve të kualifikuar të anglishtes në shkolla. Ky kurs synon t'ua ofrojë këtyre fëmijëve llojin e kursit që meritojnë dhe përmes të cilit mund të komunikojnë me lehtësi. Kjo arrihet duke treguar mënyrat dhe aplikacionet e shumta e të gjera të TIK-ut në mësimin e anglishtes si gjuhë të huaj. Nxënësit do të kalojnë nëpër përvoja mësimore që u përshtaten interesave dhe aftësive të tyre si dhe aktiviteteve të përditshme. Kursi është hartuar në mënyrë të atillë që ata do t'i shohin mësimdhënësit si partnerët e tyre në një proces mësimor të pasur dhe tërheqës.

Fëmijët mësojnë më shpejtë dhe në mënyrë më efektive kur janë të angazhuar në mënyrë aktive gjatë nxënies.



5.1 Teknologjia informative për zhvillim personal profesional

Teknologjia informative dhe e komunikimit (TIK) mund të shfrytëzohet jo vetëm për përmirësimin e të nxënësve nga ana e nxënësve, por edhe për ngritjen e mëtejshme profesionale të mësimit. Burimet e ndryshme nga interneti mund të shërbejnë për rrjetëzim profesional, hulumtime, shkëmbim idesh, si dhe si pikë referimi për krahasim gjatë reflektimit mbi nivelin tonë të zhvillimit profesional. Gjithashtu, ato mund të shfrytëzohen drejt përmirësimit të gamës, përmbajtjes, planifikimit dhe cilësisë së mësimeve tona. Teknologjia mund të përdoret edhe për reflektim dhe informatë kthyesë direkte qoftë në mënyrë individuale, qoftë përmes përkrahjes në mes të kolegëve. Kështu, video-kamera mund të përdoret për t'i regjistruar mësimit dhe për të reflektuar apo diskutuar me kolegët.

Lidhur me përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK) në Mësimdhënien e Gjuhës Angleze, vlen të përmendet mendimi i Prenskit (2001) i cili thotë se nxënësit 'e sotëm mendojnë dhe e përpunojnë informacionin thelbësisht ndryshe prej paraardhësve të tyre' duke marrë parasysh që 'nxënësit tanë janë të gjithë *folës amtarë* të gjuhës dixhitale të kompjuterëve, video-lojërave, dhe Internetit' dhe nënvizon që 'mësimdhënësit e sotëm duhet të mësojnë të komunikojnë në gjuhën dhe stilin e nxënësve të tyre.' Për më shumë: www.scribd.com; dhe www.marcprensky.com;

Siç thotë Mc Luhan, "Epoka e Ankthit tonë është, në masë të madhe, rezultat i faktit që ne përpiqemi ta kryejmë punën e sotme me mjetet e së djeshmes!"

5.2 Rëndësia e internetit

Interneti është pa dyshim burim i pashterrshëm. Përse të mos përdoren faqet e pafundme në Internet për të shkarkuar fotografi shumëngjyrëshe njerëzish, objektësh, vendesh, ambientesh? Përse të mos angazhohen nxënësit dhe të bëhen të besojnë se në fakt janë ata që po 'ju përkrahin' juve? Përse të mos shfrytëzohen të gjitha ato kuize, lojëra dhe këngë, jo vetëm për përmirësimin e shkathtësive gjuhësore, por edhe për zhvillimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve? Përse të mos përdoret sasia e pakufishme e informacioneve 'online' që nxënësit të mësojnë si të gjejnë informata në mënyrë të pavarur? Të rinjtë tashmë kalojnë një kohë të gjatë në Internet; përse të mos shfrytëzohet ky fakt dhe ta bëjmë përdorimin e Internetit të fokusuar dhe të dobishëm?


Nëse duam të ecim në një hap me zhvillimet bashkëkohore, atëherë duhet të reflektojmë dhe të përshtatemi. Kjo nënkupton përdorimin e burimeve alternative dhe burimeve në dispozicion për ta bërë mësimdhënien dhe të nxënësve, jo vetëm tërheqës dhe të pëlqyer për nxënësit, por njëkohësisht edhe efikas dhe shpërblyes për të gjithë, përfshirë mësimitdhënësit.

Shënime:

6. Mjetet relevante mësimore

6.1 Librat

Industria e teksteve shkollore (por edhe e atyre për arsimim joformal) të gjuhës angleze është zhvilluar me ritme marramendëse në dekadat e fundit. Ato janë shumë më komunikative, me ushtrime tejet të llojllojshme, me libër të nxënësit dhe me ushtrimore, me një bankë të resurseve për aktivitete plotësuese jashtëzakonisht të pasur, shumica me CD-ROM, me fjalorth të vegjël, dhe me bankë shumë të avancuar të testeve.



Në anën tjetër, në Kosovë përdoret një qasje e fragmentuar ku përfshihen tekste të reja me qasje të reja, por edhe tekste që aplikojnë një qasje statike, që në rastin më të mirë mbeten në nivelin e përciptë të ushtrimeve me përsëritje të fjalive. Disa prej këtyre kurseve janë përsëritur aq shpesh sa që mësimdhënësit kanë vështirësi të dukshme në hartimin e testeve për nxënësit. Njëkohësisht, shpesh këto tekste nuk u përshtaten kërkesave dhe qëllimeve të kurrikulës, pasi që nuk janë hartuar për të.

Në këtë kontekst, mësimdhënësit mund të përfitojnë shumë duke përdorur resurset në dispozicion në internet. Në fund të këtij doracakut janë dhënë disa adresa të cilat mund të përdoren për kompensimin e mangësive të teksteve shkollore në përdorim në shkollat kosovare. Mirëpo, këto burime elektronike do të duhej të përdreshin në funksion të zbatimit të kurrikulës dhe qëllimeve të saj, me qëllim të avancimit të shkathtësive relevante të nxënësve në fushën e gjuhës angleze (shih seksionin pararendës për kompetencat dhe shkathtësitë prioritare).

6.2 Qasjet e reja mund të zhvillohen me materiale nga përditshmëria

Ju mund të përdorni edhe materiale alternative dhe materiale shtesë. Ka shumë gjëra që mund të përdoren si materiale mësimore në mësimdhënien dhe nxënien e gjuhës angleze siç janë: të shtypura (posterë, pamflete, meny, tiketa/bileta, kartolina, pulla postare...), vizatime të thjeshta (fytyra, kafshë, objekte), fotografi të revistave, pjesë lajmesh, reklama, dhe të ngjashme. Ju mund të krijoni koleksionin tuaj të materialeve. Nëse mendoni se nuk vizatoni mirë, mund t'í angazhoni nxënësit duke u caktuar detyra konkrete (p.sh. të vizatojnë enët e kuzhinës, këlyshë, klasën...) në rast se planifikoni t'u mësoni fjalorin e duhur për këtë fushë. Me kohë, koleksioni juaj i materialeve do të rritet dhe, çka është më me rëndësi, ju mund t'í përdorni përsëri dhe mund t'í klasifikoni dhe t'í modifikoni ato, dhe gjithmonë do të keni një pako materiale të gatshme për shfrytëzim.



6.3 ... dhe materiale alternative

Interneti është pa dyshim një burim i pafund. Përse të mos përdoren qytetet e shumta për të shkarkuar fotografi me ngjyra të njerëzve, objekteve, vendeve, ambienteve? Përse të mos angazhohen nxënësit dhe të mendojnë se faktikisht janë ata që po ju 'ndihmojnë' juve? Përse të mos shfrytëzohen mjetet e shumta në dispozicion siç janë kuizet, lojërat dhe këngët, jo vetëm për të ngritur shkathtësitë gjuhësore, por edhe për të zhvilluar aftësitë e zgjidhjes së problemeve dhe ato kreative tek nxënësit tuaj? Të rinjtë tashmë shpenzojnë shumë kohë në Internet. Përse të mos shfrytëzohet ky fakt për ta fokusuar dhe konkretizuar eksperiencën e internetit?


Nëse duam të ecim me hapin e zhvillimeve bashkëkohore, atëherë duhet të reflektojmë dhe të përshtatem. Kjo do të thotë të shfrytëzojmë burime alternative dhe ato që kemi në dispozicion për ta bërë mësimin dhe të nxënien jo vetëm interesant dhe të pëlqyeshëm për nxënësit, por njëkohësisht edhe efikas për mësimdhënësit.



6.4 ... përgjigjja jonë ... përdorimi i teknologjisë

Aplikimi i teknologjisë informative në mësimdhënie dhe në të nxënë ndihmon mësimdhënësit që ta shfrytëzojnë më mirë dhe më me plan TIK-un dhe mjetet e ndryshme në punën e përditshme me nxënë.

Përdorimi i teknologjisë informative është mënyra më e mirë për lidhjen në mes së tashmes dhe së ardhmes duke i ndihmuar mësimdhënësit të përdorin strategji të reja të mësimdhënies të gjuhës angleze, por edhe të ecin me hapin e këtyre teknologjive dhe me ritmin e ndryshimeve në shoqëri.



Përdorimi i mjeteve audio-vizuele

Basic Education Program siguron pajisjet e duhura për secilin program të aftësimin të mësimdhënësve. Kështu për kursin e gjuhës angleze ofrohet teknologji për realizimin dhe editimin e video-incizimeve, të cilat mundësojnë aktivizimin dhe zhvillimin e shumë shkathtësive tek nxënësit: punën ekipore, kreativitetin, përdorimin e teknologjisë, prirjet artistike e estetike, zgjidhjen e problemeve, menaxhimin e proceseve e të tjera.

Këto mjete audio-vizuele kanë pëparësi të shumta: janë praktike, komunikojnë mirë me teknologji informative (kompjuterë, laptop), filmimet me to janë të përshtatshme për editim dhe publikim në ueb faqe, lehtë u shtohen titrat dhe muzika, dhe mund ta përdorin si nxënësit, ashtu edhe mësimdhënësit në punën e tyre.

Shënime:

Flip-kamera përdoret për ngritjen profesionale të mësimdhënësve:

Flip-kamera, përveç përdorimit për qëllim të nxënies tek nxënësit (e përshkruar në aktivitetet paraprake), mund të përdoret edhe për ngritjen profesionale të vet mësimdhënësve. Duke e vëzhguar veten gjatë punës në klasë, mësimdhënësit mund të jenë vet dëshmitarë të pikave të forta dhe të dobëta të orës mësimore, si dhe mund të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies së tyre, duke i zhvilluar kështu kriteret e brendshme për planifikim dhe zbatim të njësive të ardhshme.

Është me rëndësi të theksohet se video-xhirimet e orëve mësimore nuk ka nevojë t'i shohë askush përveç vet mësimdhënësit. Ato mund të jenë vetëm mjet për reflektim/vetë-vlerësim. Megjithatë, nëse mësimdhënësi vendos, mund t'ia tregojë videon kolegëve për t'u ndihmuar atyre apo për të marrë këshilla nga kolegët. Mësimdhënësit mund ta publikojnë videon e vet në ndonjë ueb faqe të rrjeteve edukative si **BEP Connect**, **KELT Connect**, **KETNET** apo **ketnetweebly.com**.



Aktiviteti (15 minuta): Qëllimi i këtij aktiviteti është të inkurajohen mësimdhënësit për përdorimin e xhirimeve gjatë orëve të veta mësimore si mjet për ngritje profesionale duke e larguar frikën dhe pasigurinë nga procesi mësimor dhe duke i vërejtur përparësitë.

Pjesëmarrësit të ndahen në çifte për t'iu përgjigjur pyetjes në vijim (të shkruar në powerpoint apo në letër table). Pastaj çiftet i shkëmbejnë përgjigjet dhe i diskutojnë me grupin e vet para se ta diskutojnë me grupin e madh. Pasi të mblidhet i tërë grupi, fasilitatori u kërkon individëve t'i prezantojnë kontributet e tyre (apo të grupit) më të mira për secilën pyetje, dhe e trajton ndonjë brengë apo dyshim të mundshëm në lidhje me këtë mjet të Ngritjes Profesionale.

- Pse mendoni se vëzhgimi i vetes gjatë mësimdhënies është mjet i mirë për ngritje profesionale?
- Si mund t'ju ndihmojë ky mjet i NP në vendin tuaj të punës dhe në promovimin në karrierën tuaj të mësimdhënësit?
- Çka do t'u thuani nxënësve tuaj para video-xhirimit të orës mësimore?
- Çka do të bënit saktësisht gjatë vëzhgimit të orës së xhiruar?
- Shkruani ide specifike – pyetje që do t'ia parashtronit vetes.

7. Çka të mësojmë?




7.1 Përcaktimi i qëllimeve dhe rezultateve mësimore

Përdorimi i gjerë i gjuhës angleze në Kosovë dhe në botë paraqet një medium shembullor komunikimi për të gjithë. Si i tillë, zhvillimi i shkathtësisë së komunikimit në gjuhën angleze përbën edhe objektivin e parë të të nxënit. Mirëpo, sikurse edhe çdo gjuhë tjetër, të nxënit e gjuhës angleze mundëson edhe të nxënit për numër të pakufishëm të temave, duke ndihmuar kështu zhvillimin e shkathtësive të tjera të të rinjve – përveq atyre gjuhësore. Në kontekstin e të nxënit të gjuhës angleze vend të theksuar zë mësimi dhe zhvillimi i shkathtësive për përdorimin e teknologjisë së informimit e të komunikimit. Burimet e panumërta në internet, kompjuterët, teknologjia e komunikimit, e të tjera, pa dyshim se mund të përdoren shumë më mirë nëse mësohet gjuha angleze.

Nuk do mend se ky relacion është i ndërsjellë, sepse edhe teknologjia informative është medium i pazëvendësueshëm për të nxënit e gjuhëve të huaja. Për këtë rol të teknologjisë dhe për rëndësinë e të nxënit të gjuhës angleze do të flitet më shumë në vazhdim të kësaj pjese të doracakut.



8. Si të mësojmë?



8.1 Këndvështrimi i mësimdhënësve

Shpesh dëgjojmë që mësimdhënësit janë lodhur nga ndryshimet e shumta në metodologjitë e mësimdhënies. Disa mësimdhënës shprehin që u është dashur të mësojnë si të japin mësim shumë herë gjatë karrierës së tyre. Një fakt për të cilin të gjithë pajtoheni është se të jesh mësimdhënës nuk është e lehtë. Mësimdhënësit thonë se janë lodhur nga trajnimet e shpeshta në ambiente të këndshme, por përvoja e fituar aty ose nuk është aq relevante për përmirësimin e mësimdhënies në klasë, ose nuk aplikohet nga menaxhmenti i shkollës. Gjithashtu, mësimdhënësit theksojnë domosdoshmërinë e pajisjeve dhe kushteve më të mira të punës për aplikimin e mësimdhënies më moderne dhe metodave të fundit në klasat e tyre.



8.2. Reagimi ndaj ndryshimeve marramendëse

Megjithatë, pranohet përgjithësisht se gjërat – përfshirë edhe metodologjitë e mësimdhënies po ndryshojnë me një ritëm që as që do të mund të paramendohej para pak dekadave. Këto ndryshime mund të menaxhohen vetëm nëse ka përkushtim ndaj zhvillimit të vazhdueshëm profesional, përkushtim për vazhdimësinë e filozofisë së të mësuarit të përjetshëm tek nxënësit, dhe gatishmëri për t'u angazhuar nganjëherë në 'të mësuarit' e mënyrave të reja të mësimdhënies.



8.3 Misioni i ri në rrethanat e ndryshuara

Ngritja profesionale e mësimdhënësve është detyrim nëse mësuesi dëshiron ta vazhdojë profesionin dhe të provojë ndjesinë e përbushjes së misionit të vet në mënyrën më të mirë të mundshme. 'Mënyra më e mirë e mundshme' nënkupton që ne të arrijmë jo vetëm të japim lëndën tonë, por edhe t'i pajisim nxënësit me shkathtësi për gjithë jetën të cilat ata i vënë në punë në klasë dhe jashtë saj, në shkollimin e mëtejshëm dhe në punë, nëse arrijnë të zgjidhin detyra të ndryshme që u caktohen në ambientin shkollor dhe jashtë tij.



8.4 ... çfarë mësimdhënie?

Kështu pra, një nga shqetësimet më të mëdha të mësimdhënësve, dhe detyra e tyre primare në një klasë me nxënësin në qendër, është krijimi i mundësive për të nxënë. Duke pasur parasysh aftësitë dhe nevojat individuale të nxënësve, për t'ia arritur kësaj mësimdhënësi duhet të provojë qasje të ndryshme, të zbatojë një sërë strategjish dhe teknikash për të krijuar një ambient mësimor miqësor për nxënësin, duke e ditur që ka një mori faktorësh të ndërlidhur që çojnë drejt suksesit, ose dështimit (Lightbaum & Spada, 1999). Kjo nënkupton reflektim të vazhdueshëm, transformim dhe përshtatje të qasjeve (Richards & Rodgers, 2001). Në kërkim të 'metodës më të mirë' shumë mësimdhënës pajtohen që 'metoda më e mirë' është ajo që jep rezultatet më të mira në një klasë të caktuar, me një grup të caktuar nxënësish.

8.5 ... qasjet bashkëkohore

Qasjet komunikative, të nxënësve përmes detyrave, dhe të nxënësve përmes projekteve ofrojnë mundësi të shumta për nxitjen e kureshtjes dhe motivimin e nxënësit, për ta angazhuar nxënësin në aktivitetet e klasës dhe për të lehtësuar zhvillimin e mëtejshëm të shkathtësive, aftësive dhe kapaciteteve të tij, p.sh. gjetjen e një adrese duke përdorur hartën, matjen e dimensioneve të një objekti, ndërtimin e një aeroplani lodër, etj. Duke kryer detyra, duke marrë përsipër një projekt, duke punuar në grupe, duke ndërvepruar e bashkëpunuar, duke ndarë gjërat dhe duke bashkëndjerë me të tjerët, duke ndarë punën dhe përgjegjësitë, nxënësit zhvillojnë shkathtësitë e tyre personale dhe ndërpersonale dhe përgatiten më mirë për ambientin e punës që i pret në situata të jetës së përditshme.

Shënime:




Shembuj të mësimit të gjuhës angleze përmes teknologjisë dhe qasjet e reja bashkëkohore.

9. Shembuj të qasjeve të reja për përvoja të papërsëritshme të të nxënit



9.1 Mësimi i Gjuhës Angleze me Ndhmën e Kompjuterit (MGJNK)

Deri kohëve të fundit, mësimi i gjuhës me ndihmën e kompjuterit (MGJNK) ka qenë temë e rëndësishme vetëm për ata që kanë pasur interesim të veçantë për këtë fushë. Por tash së voni kompjuterët janë përhapur aq shumë nëpër shkolla dhe shtëpi dhe përdorimi i tyre është shtuar në mënyrë aq dramatike sa që shumica e mësimeve të gjuhëve tani duhet gjithsesi të merren me përfshirjen e kompjuterëve në mësimin e gjuhëve¹.



1 Warschauer, M. (1996) "Computer Assisted Language Learning: an Introduction". In Fotos S. (ed.) Multimedia language teaching, Tokyo: Logos International: 3-20. www.ict4lt.org/en/warschauer.htm 0

Kompjuterët, të cilët në vendet e zhvilluara kanë hyrë në shkolla kah fundi i viteve 1950ta, sot janë duke u zhvilluar çdo ditë e më shumë në tërë botën. Në gjysmën e dytë të shekullit të 20të, teknologjitë që lidhen me arsimin kanë qenë ndër fushat më të zhvilluara në botë. Sot, ato janë bërë edhe më të fuqishme, më të shpejta, më lehtë të përdorshme, më të përshtatshme dhe më të lira, si dhe mund të përpunojnë dhe ruajnë shumë më shumë të dhëna.

Me shpejtësi të madhe janë zhvilluar edhe pajisjet, siç janë, hard disqet, CD ROM-ët, disqet laserike dhe shtypësit që përdoren me kompjuterë. Duke shfrytëzuar këto, programi i kompjuterit mund të rregullojë tingullin, fotografitë dhe videon, bashkë me shkronjat e personazhet². ... Edhe softueri për MGJNK-në po ashtu mund të gjendet shumë më lehtë në treg³.

... komunikimi përmes kompjuterit dhe Interneti e kanë ri-formësuar përdorimin e kompjuterëve për mësimin e gjuhës. Kompjuterët më nuk janë vetëm mjet për përpunimin dhe paraqitjen e të dhënave, por janë edhe mjet për përpunimin e informatave dhe për komunikim. Nxënësit e gjuhëve, tani janë në gjendje që me ndihmën e internetit të komunikojnë njëkohësisht me nxënësit e tjerë ose me njerëzit në të gjithë botën të cilët e flasin atë gjuhë.

Megjithatë, siç thekson Dhaif (1989 në Gündüz), kompjuterët kurrë nuk mund të zëvendësojnë mësimdhënësin "e gjallë", veçanërisht në mësimin e gjuhës, ku theksi vihet në komunikimin e ndërsjellë ndërmjet njerëzve. Ai mund të luajë një rol në mësimin e gjuhës së dytë ose gjuhës së huaj si një instrument ndihmës për mësimdhënësin⁴.

Numri i mësimdhënësve që e përdorin Mësimin e Gjuhës me Ndhimën e Kompjuterit (MGJNK) është rritur dukshëm si dhe janë shkruar një varg artikujsh rreth rolit që luan teknologjia në arsim në shekullin 21. Ndonëse ende nuk është hulumtuar sa duhet mundësia e përdorimit të internetit në arsim dhe se shkollat e zakonshme ende i përdorin kompjuterët në mënyrë të kufizuar, është e qartë se kemi hyrë në një epokë të re informative në të cilën tashmë është krijuar lidhja ndërmjet teknologjisë dhe TEFL.



2 Gündüz, N. Computer Assisted Language Learning (CALL)???

3 Ittelson, J C. (2000). Computers. Microsoft encarta encyclopedia 2000. 1993-1999 Microsoft Corporation. Cited in Gündüz, N. Op. Cit. www.jlls.org/Issues/Volume1/No2/nazligunduz.pdf

4 Dhaif, H. A.(1989). Can computers teach languages? English teaching forum.27(3),pp.17-19. In Gündüz, N. Op. Cit.

Duke marrë parasysh vargun e gjerë të përfitimeve, hulumtimet dhe praktika tregojnë se nëse zbatohet si duhet, teknologjia e bazuar në rrjetin e internetit mund të kontribuojë shumë në të mësuarit përmes përvojës, në motivim dhe në arritjen më të mirë të studentëve. Përveç kësaj, sipas tij, teknologjia e bazuar në rrjetin e internetit ofron materiale autentike për studim, individualizim, ndërveprim më të madh, pavarësi nga një burim i vetëm i informatave dhe të kuptuar global. Ai e sqaron secilën prej këtyre pikave si në vijim:

a) Të mësuarit përmes përvojës

Rrjeti Botëror i Internetit (www - World Wide Web) ua bën të mundur nxënësve që të kenë qasje të papenguar në një masë të madhe të dijes e të përvojës njerëzore. Në këtë mënyrë, ata mund të mësojnë duke i bërë gjërat vet. Ata bëhen krijues e jo vetëm pranues të njohurive. Meqë mënyra se si paraqitet një informacion nuk është lineare, përdoruesit zhvillojnë aftësi të të menduarit dhe zgjedhin se çka duan të hulumtojnë.

b) Motivimi


Kompjuterët janë shumë të popullarizuar tek nxënësit për shkak se ata lidhen me argëtim dhe lojëra por edhe për faktin se ata konsiderohen se janë në modë. Prandaj kjo ka rritur motivimin e nxënësve, veçanërisht kur ata ofrojnë një varg aktivitete, të cilat i bëjnë ata që të ndjehen më të pavarur.

c) Të nxënësve më efektiv

Përdorimi i internetit për të nxënë mund t’u ndihmojë nxënësve që t’i forcojnë aftësitë e tyre gjuhësore duke ndikuar pozitivisht në qëndrimin e tyre ndaj të nxënësve ose duke i ndihmuar ata që të krijojnë strategji të nxënësve të pavarur dhe që ta promovojë vetëbesimin e tyre.

d) Materialet autentike për studim

Të gjithë nxënësit mund të përdorin burime të ndryshme të materialeve autentike të leximit qoftë në shkollë apo nga shtëpia e tyre. Qasja në ato materiale është në dispozicion 24 orë në ditë dhe me një çmim relativisht të ulët.



e) Ndërveprim më i madh

Qasja e kohëpaskohshme në faqet e internetit e thyen rrjedhën lineare të mësimin. Duke dërguar emaila dhe duke iu bashkuar grupeve për pranimin e lajmeve, nxënësit e gjuhës angleze si gjuhë e huaj mund të komunikojnë me njerëz që kurrë nuk i kanë takuar. Ata po ashtu mund të ndërveprojnë edhe me shokët e tyre të klasës. Madje, disa aktivitete në internet u japin nxënësve informacione kthyesive pozitive dhe negative duke ua korrigjuar automatikisht ushtrimet e tyre në internet.

**f) Individualizimi**

Nxënësit e ndrojtur ose që nuk mund të shprehen lirshëm mund të përfitojnë shumë nga të mësuarit e individualizuar dhe bashkëpunues që e ka nxënësin në qendër. Edhe ata që arrijnë shumë mund të realizojnë potencialin e tyre të plotë pa u penguar nga bashkëmoshatarët e tyre që të punojnë sipas dinamikës që u përshtatet atyre.

g) Pavarësia nga një burim i vetëm i informacioneve

Ndonëse nxënësit mund të vazhdojnë të përdorin librat e tyre, atyre u jepet mundësia që t'u shmangen njohurive të mbyllura dhe të zbulojnë me mijëra burime të informacioneve. Si rezultat i kësaj, shkollimi i tyre e plotëson nevojën për mësim ndërdisiplinor në një botë shumëkulturore.

h) Të kuptuarit global

Një gjuhë e huaj mësohet në kontekstin e saj kulturor. Në një botë ku përdorimi i internetit po bëhet gjithnjë e më i përhapur, është detyrë e çdo mësuesi të gjuhës angleze që t'ua mundësojë nxënësve qasjen në internet dhe t'i bëjë ata të ndjehen qytetarë të një klase mësimore globale, duke ushtruar komunikimin në nivel global.

Ekziston një numër aktiviteteve gjuhësore që mund të zhvillohen me përdorimin e teknologjisë së bazuar në rrjet, si fjalorët dhe enciklopeditë, lidhjet me mësuesin, dhomat e bisedave (chat-rooms), tutorët e shqiptimit, kuizet për gramatikë dhe fjalor, lojërat dhe gjëgjëzat, fragmentet letrare, komunikimin me shokët e korrespondencës elektronike, hartimet e projekteve.

"Nxënësit e sotëm mendojnë dhe përpunojnë informata që dallojnë krejtësisht nga ato të paraardhësve të tyre, duke marrë parasysh se 'Të gjithë nxënësit tonë sot e kanë 'gjuhë amtare' gjuhën digjitale të kompjuterëve, video-lojërat dhe internetin' dhe duke avokuar se 'mësuesin e sotëm duhet të mësojnë të komunikojnë në gjuhë dhe stilin e studentëve të tyre.'" Prensky (2001).

Bashkë me metodologjitë e mësimit dhe nxënies që MGJNK-ja i ka sjellë në klasë, në të njëjtën kohë ajo e ka ndryshuar edhe rolin e mësimit. Mësuesin nuk janë më vetëm burim i informatave, por veprojnë si lehtësues në mënyrë që nxënësit të mund t'i interpretojnë dhe organizojnë në mënyrë aktive informatat që i marrin, duke i përfshirë ato në grumbullin e njohurive që i kanë pasur më herët (Dole, et al., 1991). Nxënësit janë bërë pjesëmarrës aktivë në mësim dhe inkurajohen që të jenë hulumtues dhe krijues të gjuhës e jo vetëm pranues pasiv të saj (Brown, 1991). MGJNK-ja integruese thekson këto çështje si dhe u mundëson nxënësve të gjuhës të komunikojnë pa shpenzime të mëdha më nxënësit e tjerë ose edhe me folësit që atë gjuhë e kanë gjuhë amtare. Si e tillë, ajo kombinon përpunimin e të dhënave, komunikimin, përdorimin e

gjuhës autentike dhe autonominë e nxënësit, që të gjitha këto shumë të rëndësishme në teorinë e sotme të mësimit të gjuhës.

Përfitimet e sotme që sjell përdorimi i komunikimit përmes kompjuterit dhe internetit në lehtësimin e një qasjeje integrale ndaj përdorimit të teknologjisë janë të qarta. Megjithatë, duke pasur parasysh parashikimet për të ardhmen e teknologjive të reja, veçanërisht parashikimin e problemeve, Davis⁵ paraqet një përmbledhje të gabimeve gjatë historisë të cilat më së miri ilustrojnë rrezikun kur dikush bën gjykime të ngutshme për inovacionet në teknologji:

Si reagojmë ndaj ndryshimeve: keqkuptimet më të popullarizuara?

Telefoni: “Ky farë ‘telefoni’ ka shumë mangësi që të konsiderohet seriozisht si mjet i komunikimit. Kjo pajisje është krejtësisht e pavlerë për ne.”


Memorandum i brendshëm i Western Union, 1876.

Radio: “Kutia muzikore pa tela nuk ka ndonjë vlerë të imagjinueshme komerciale. Kush do të paguaj për një mesazh që nuk do t’i dërgohet askujt në veçanti?”

Disa bashkëpunëtorë anonimë, duke iu përgjigjur David Sarnoff, themeluesit të RCA, i cili në vitet e 1920ta nxiste investimin në radio.

Kompjuteri: “Mendoj se ndoshta në botë ka treg për pesë kompjuterë.”
Thomas Watson, Themelues i IBM, 1943.

Kompjuteri: “640K do të jetë memorie e mjaftueshme për çdokënd.”
Bill Gates, 1981 (ai thuhet ta ketë thënë këtë, por ai e mohon).



5 Davis, G. Op. Cit.

9.2 Qasjet komunikuese dhe të nxënit e bazuar në detyra

TË NXËNIT PËRMES DETYRAVE

Duke marrë parasysh informatat e shumta dhe rrjedhimisht, llojet e ndryshme të të nxënit, qasjet bashkëkohore promovojnë të mësuarit aktiv. Qasjet komunikative, të nxënit e bazuar në detyra, dhe të nxënit e bazuar në projekte ofrojnë një varg mundësish për të zgjuar kureshtjen dhe motivimin e nxënësve, për të angazhuar nxënësit në aktivitetet në klasë dhe për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, shkathtësive, mundësive dhe qëndrimeve të tyre. Në klasë, nxënësit mund të angazhohen në përmbushjen e një vargu detyrash. Pyetja që ngrihet në këtë rast është: “Çka konsiderohet si detyrë?”

Çka është detyra?

Detyrë është çdo aktivitet i cili ka për qëllim që të arrijë një qëllim konkret duke aplikuar një procedurë ose një varg procedurash ose një varg strategjish. Mbështetësit e të nxënit të bazuar në detyra e pranojnë botërisht se detyrë në klasë mund të jetë çdo gjë, p.sh., gjetja e një lokacioni, leximi i hartës, gjetja e një zgjidhjeje të një gjëgjëze, gjetja e një adrese përmes leximit të hartës, dhe matja e dimensioneve të një objekti. Detyrë mund të jetë edhe ndërtimi i një aeroplani lodër, ose parashikimi i fatit duke ndjekur udhëzimet e mësimdhënësit, hartimi i planit të objektit të shkollës, porositja e një ushqimi duke lexuar menynë, bërja e një telefonate dhe të ngjashme.



Karakteristikat dhe përparësitë e të nxënit të bazuar në detyra:

Përparësitë e pranuar botërisht të qasjes përmes komunikimit dhe të nxënit të bazuar në detyra janë si vijon:

- Në procesin e mësimin, nxënësit nuk e studiojnë gjuhën, por ata marrin pjesë në aktivitetet të cilat kanë vlerë të shkollimit praktik;
- Temat dhe fushat e mësimin janë në sferën e interesit të nxënësve, gjë që duhet të rris nivelin e motivimit dhe angazhimit;
- Nxënësit i ekspozohen gjuhës angleze në formën e saj natyrale, autentike dhe jo-artificiale. Kjo gjuhë ka gjasë të jetë kuptimplotë, e me këtë është e kuptueshme se edhe aktivitetet janë kuptimplotë.
- I tërë aktiviteti zhvillohet në gjuhën angleze, prandaj nxënësit e konsiderojnë gjuhën angleze si mjet të komunikimit e jo si një produkt final;
- Gjuha nuk mësohet përmes një grumbulli strukturash gramatikore. Fitimi i njohurive dhe perceptimi i realitetit bëhen në gjuhën angleze, kështu që gjuha që dëshirohet të mësohet përdoret edhe si mjet edhe si qëllim;

- Mësimi bëhet në grupe me nxënës që kanë njohuri të ndryshme. Grupet me aftësi të ndryshme janë të pashmangshme në të gjitha fazat e mësimit të gjuhës nëpër shkolla. Megjithatë, kjo kthehet në përparësi në qasjet komunikuese dhe në mësimin e bazuar në detyra. Nxënësit me sfond të dobët të njohurive përfitojnë nga puna grupore pasi që duke bashkëpunuar në një detyrë ata mësojnë jo vetëm nga mësimdhënësi dhe materialet e tyre, por edhe nga bashkëmohatarët e tyre.

- Në procesin e të nxënës, vëmendja fokusohet tek nxënësit si individë, prandaj nxënësit inkurajohen që të studiojnë dhe mësojnë sipas dinamikës së tyre duke përdorur stilin e tyre të preferuar të nxënies.

Qasjet përmes komunikimit dhe të nxënës të bazuar në detyra kërkojnë që të fillohet nga roli tradicional i mësimdhënësit, si dhe i nxënësit⁶. Në mësimin e gjuhës përmes komunikimit roli kyç i mësimdhënësit është që ta lehtësojë mësimin, që kryesisht nënkupton se:

- Ai/ajo i koordinon aktivitetet në klasë. Rrjedhimisht, roli i mësimdhënësit është më pak dominues, dhe e obligon atë që ta vë theksin në kontributin e nxënësve përmes mësimit të pavarur me burimet e dhëna;
- Si drejtues i klasës, mësimdhënësi është përgjegjës për grupimin e aktiviteteve në 'mësimë';
- Në disa aktivitete mësimdhënësi mund të luajë rolin e instruktorit të gjuhës duke paraqitur gjuhën e re, duke pasur kontroll të drejtpërdrejtë mbi performancën e nxënësve, vlerësimin dhe përmirësimin e saj;
- Në aktivitetet e tjera, ai/ajo mund të ndërveprojë, por nuk do të lejojë që mësimi të zhvillohet përmes aktiviteteve të pavarura;
- Në aktivitetet gjuhësore, klasa ndahet në çifte dhe grupe të cilat ndërveprojnë në mënyrë të pavarur nga mësimdhënësi. Në aktivitetet e pavarura ai/ ajo mund të veprojë si mentor, këshilltar ose monitorues, për t'i zbuluar pikat e dobëta dhe të forta të nxënësve, të cilat ai/ ajo do t'i përdorë si bazë për planifikimin e aktiviteteve mësimore;
- Herë pas here, mësimdhënësi mund të marrë pjesë në aktivitete si 'komunikues' që stimulon dhe që prezanton gjuhën e re, por duke ua lënë iniciativën vet nxënësve. Me marrjen e rolit të 'komunikuesit' mësimdhënësi e vë veten në baza të barabarta me nxënësit. Kjo ndihmon në uljen e tensionit dhe tejkalimin e pengesave ndërmjet tyre, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm për të mësuar. Si pasojë, raportet në mes të nxënësve dhe në mes të mësuesit dhe nxënësve janë më të relaksuara dhe më bashkëpunuese, gjë që mundëson ndërveprimin;
- Nxënësit nuk korrigjohen vazhdimisht. Gabimet trajtohen me më shumë tolerancë, si fenomen normal në zhvillimin e aftësive komunikuese, ku fokusi vihet në të folurit e rrjedhshëm e jo në saktësi.

ILUSTRIM I NJË AKTIVITETI TË TË NXËNIT PËRMES DETYRAVE:

Nga një varg i gjerë i detyrave do të përshkruhet vetëm një aktivitet i mundshëm për të ilustruar rëndësinë, rolin, efektivitetin dhe begatinë e përfitimeve që kanë qasjet komunikative dhe ato të të nxënës të bazuar në detyra në stimulimin e komunikimit dhe ndërveprimin ndërmjet nxënësve në klasë. Ky aktivitet është veçanërisht i përshtatshëm në kontekstin e Kosovës për përgatitjen e të cilit as nuk kërkohet shumë kohë e as materiale të veçanta:


- Mësimdhënësi vizaton një numër vijash të drejta në dërrasë në mënyrë të çrregullt të cilat e presin njëra tjetrën, ose e sjell një vizatim të përgatitur paraprakisht (shih diagramin 1) dhe ua paraqet atë nxënësve. Ky aktivitet mund të zhvillohet në grupe të vogla. Në këtë rast mësimdhënësi duhet ta fotokopjojë diagramin për secilin grup.

⁶ Littlewood, W. 1981. Communicative Language Teaching. Cambridge University Press.

- Nxënësve u kërkohet që t'i krahasojnë vijat dhe të tregojnë se cila vijë është më e shkurta/ më e gjata.
- Nëse vijat vizatohen me ngjyra të ndryshme, detyra bëhet iluzion optik dhe klasifikohet si lojë psikologjike⁷.

Pas krahasimit dhe spekulimit për gjatësinë e vijave, nxënësve u kërkohet që t'i masin ato, me qëllim që të fillojë një diskutim që ka të bëjë edhe me gjuhën angleze edhe me matematikën dhe arrihet qëllimi konkret për përmbushjen e detyrës.

Diagrami



Cilat janë përfitimet nga përmbushja e kësaj detyre?

- Pikë së pari nxënësit inkurajohen që të mendojnë në mënyrë kritike, të vlerësojnë, të flasin, të ndërveprojnë dhe të bashkëpunojnë;
- Përveç kalimit në sekuenca të ndryshme (forma, numra, njësi matëse, ngjyra), me këtë arrihen edhe qëllimet gjuhësore.

Elementet gjuhësore që janë të integruara në përmbushjen e detyrës janë të shumta. Së pari, nxënësit ofrojnë shembuj të krahasimit të mbiemrave duke përdorur si format krahasore ashtu edhe ato sipërore në gjuhën angleze:

- ***Unë mendoj se kjo vijë është më e gjatë.***
- ***Kjo është më e shkurtër.***
- ***Mua më duket se vija e kaltër dhe vija e gjelbër janë të njëjta.***
- ***Vija e kuqe është më e gjata.***

⁷ Wright, A., D. Batteridge & M. Buckby. Games for Language Learning. Cambridge University Press.

- Përveç kësaj, ushtrohet edhe koha e tashme e thjeshtë:
 - ***Ke të drejtë. Kjo vijë është më e gjatë/ më e shkurtër se ajo tjetra.***
 - ***E ke gabim. Ajo është...***
 - ***Unë mendoj se...***

Është shumë me rëndësi fakti se aspekte të caktuara gjuhësore përdoren pa e fokusuar vëmendjen e nxënësve në formën e tyre. Prandaj ato aspekte mësohen pa ndonjë përpjekje të vetëdijshme për t'i mësuar rregullat. Me fjalë të tjera, përmes integritit të aftësisë gjuhësore, nxënësit komunikojnë duke u fokusuar në përmbajtjen e detyrës, që do të thotë në kuptimin e jo në formën e saj. Kjo e parandalon përdorimin e gramatikës si forcë shtytëse dhe mundëson që ajo të rrjedh nga aktivitetet në klasë, që është edhe një ndër qëllimet kryesore të mësimin të gjuhës përmes komunikimit.

Ky aktivitet i komunikimit mund të zgjerohet më tej duke kërkuar nga nxënësit që t'i shkruajnë emrat e kolegëve të tyre mbi secilën vijë sipas ngjyrës së rrobave të tyre, p.sh., mbi vijën e kuqe dikush e shkruan emrin Arta, Blerta, etj, mbi vijën e kaltër shkruan Edon, Drita, Altin, etj. Pas kësaj faze të detyrës, nga nxënësit mund të kërkohet që duke formuar fjali t'i japin arsyet pse i kanë shkruar disa emra të caktuar në vija të caktuara duke punuar në çifte ose në grupe (me gojë ose me shkrim), p.sh.

Arta ka të veshur një fustan të kuq.

Blerta ka një bluzë të kuqe.

Edoni ka të veshur një këmishë të kaltër.

Drita ka të veshur një fund të kaltër.

Kështu do të arrihet një qëllim tjetër: do të ushtrohet funksioni gjuhësor i përshkrimit të pamjes fizike të njerëzve. Për më tepër, do të arrihet qëllimi gjuhësor: do të mbulohen koha e tashme e thjeshtë (Blerta ka një bluzë të kuqe) dhe koha e tashme e vazhdueshme (Ajo/ Ai ka të veshur...). Në fund, ne mund të kërkojmë nga nxënësit që ta shkruajnë një përshkrim të shkurtër të pamjes fizike të shokut për të krijuar mundësi për konsolidimin dhe/ ose vlerësimin e nivelit të arritjes së tyre në mësim. Siç mund të shihet, aktiviteti i mbulon katër aftësi gjuhësore: fillimisht, dëgjimin dhe të folurit, e pastaj leximin dhe shkrimin. Për më tepër, ai ofron mundësi për vlerësimin e vetvetes dhe të kolegëve.

A ke dëshirë ta bësh diktimin një aktiviteti tërheqës për nxënësit – Atëherë provo Diktimin Online

Qëllimi i një ushtrimi të këtillë është përdorimi i aplikacioneve në internet i një mjeti online (për ushtrimin e diktimit) i cili megjithatë ruan lidhje me mënyrën e mëparshme të të nxënësve të gjuhës angleze. Kjo për arsye se shumica e mësimit të gjuhës angleze në Kosovë janë të njohur me këtë qasje gjatë shkollimit dhe studimeve të tyre. Megjithatë qasja e cila promovohet me këtë aplikacion në internet e tejkalon praktikën e vjetër të komunkimit në një drejtim.

Mundësia e ndërveprimit, kthimit të tekstit, kontrollimit dhe korrigjimit lejon përjetim më të mirë të ushtrimit të diktimit por edhe përshtatje të aftësive individuale të nxënësve – ashtu që nxënësit e hartojnë vet hapin e përparimit të tyre (me apo pa mbikëqyrje të mësimit të gjuhës). Ky individualizim i të nxënësve me këtë mjet online bëhet edhe më i përshtatshëm, pasi që ky aplikacion e ka mundësinë edhe të ngadalësimin edhe të shpejtimit të leximit nga ana e kompjuterit, si dhe tekste për nivele të ndryshme të kompetencës gjuhësore (të cilat mund të zgjedhen lirisht nga nxënësi/mësimit të gjuhës). Ndër përparësitë më të mëdha të këtij ushtrimi është mundësia e vlerësimit për të nxënësve - ashtu që nxënësi ka informata kthyesë për performancën e vet aty për aty dhe mund të përmirësohet duke 'krijuar' rregullat e veta për njohuritë e reja.

Një sfidë e këtij ushtrimi online është se në situatë ideale (për ta mundësuar qasjen e individualizuar) secili nxënësi duhet të punojë në një kompjuter me qasje në internet. Kjo mund të kompensohet deri diku me përdorimin e projektorit ose edhe me punë në grupe duke përdorur një kompjuter me qasje në internet (duhen vetëm një palë amplifikator të zërit).

Po ashtu zbatimi i këtij aktiviteti në klasë mund të çojë edhe te përdorimi i tij i pavarur nga ana e nxënësve në shtëpi (ku shumica prej tyre tashmë kanë kompjuter).

Ky aplikacion ndërveprues online mundëson të nxënësve të individualizuar, punë në çift, punë në grupe, e të tjera dhe zhvillon shkathtësitë e të shkruarit, leximit dhe dëgjimit.

Kushtet: Aktiviteti mund të bëhet në laboratore të informatikës ku secili nxënësi punon në një kompjuter me qasje në internet. Ushtrimi mund të zbatohet edhe në klasë, ashtu që dy e më shumë nxënësit (në grupe deri në pesë veta) punojnë në një lap-top.

Adresat e web faqeve:

www.englishclub.com/listening/dictations-short.htm,

www.learnenglish.de/Dictation/edictationtheuk.html

A ke dëshirë që dialogu të përjetohet si situatë reale? – Atëherë provo Videotregimin

Tregimi Vizual/Dixhital/Videotregimi



Si ta punoni tregimin tuaj dixhital:

- **Shkrimi paraprak:** shkëmbim ideshë, mbledhja e fotove, hulumtimi, skicimi, dhe tregimi vizual/dixhital
- **Hartimi/Projektimi:** krijimi i skenarit dhe dhënia e formës
- **Rishikimi:** modifikimi dhe organizimi i fotove
- **Redaktimi:** prerjet periodike (kohore), fotot dhe rrëfimi
- **Publikimi:** produkti përfundimtar

Çfarë është Videotregimi? Storyboarding?

Videotregimi apo Storyboarding, është një prezantim vizual që ndihmon procesin e krijimit të tregimit të një historie në format dixhital. Videotregimet paraqesin imazhe në sekuenca kronologjike (të njëpasnjëshme) duke krijuar rrjedhën e produksionit. Gjithashtu, ato mund të përfshijnë aspekte teknike dhe të dizajnit.


Pse ta përdorim Videotregimin?

“Jeta është një skenë e ne jemi aktorë në të” (As you like it, Shakespeare).

Jeta nuk është e ndarë, çdo pjesë të saj e jetojmë të integruar me pjesët tjera. Edhe gjuha është po ashtu pjesë e saj. Siç e jetojmë jetën ashtu e vlen ta mësojmë edhe gjuhën. Këtë na e mundëson videotregimi. Nxënësit e përdorin gjuhën angleze përderisa e krijojnë dhe xhirojnë një tregim. Por e tërë kjo bëhet si pjesë e një tregimi të tërë. Gjatë këtij aktiviteti nxënësit zhvillojnë dhe praktikojnë njohuri të caktuara të gjuhës angleze të cilat ju si mësimdhënës i keni caktuar, por në të njëjtën kohë ata zhvillojnë imagjinatën dhe kreativitetin, zhvillojnë shkathtësi të punës në grup, shkathtësi prezantimi, xhirimi e editimi, dhe mbi të gjitha u ndihmon që ta përdorin gjuhën angleze si pjesë të një situatë reale e jo të ndarë artificialisht.

Videotregimi u ndihmon nxënësve edhe për vetëvlerësim sepse e shohin veten dhe mund të bëjnë korrigjime pas xhimit të dialogut.

Tabela e mëposhtme tregon se si mund të organizohen skenat elementare të një tregimi dixhital.



Dhe, pasi të jenë planifikuar të gjitha skenat, mund të krijohet një videotregim më i detajuar. Kjo i jep zhvilluesit (producentit?) të tregimit dixhital një ide shumë më të qartë lidhur me elementet që do të jenë pjesë e punimit dhe si do të bashkohen ato.



Modelet e Videotregimit dhe Burime të Tjera

[Vegëza për modelin e videotregimit.](#) Ky është një dokument (file) në format PDF që paraqet një videotregim vertikal të zbrazët.

[Krijimi i videotregimit në programin Word.](#) Ky është një udhëzues që tregon se si krijohet videotregimi duke përdorur programin Microsoft Word⁸.

Rolet në Video-Projekt

Rolet mund të përfshijnë tituj si **Drejtor Ekzekutiv, Drejtor, Producent, Hulumtues, Skenarist, Artist i Tregimit Vizual, Dizajner i Vendxhirimit, Kameraman, Zërues, Redaktor Filmi, Artist Grafik, dhe Aktorët.** Varësisht nga numri i njerëzve të përfshirë në video-projekt, rolet mund të kombinohen dhe mund t'i caktohen një personi, ose dy persona mund të caktohen të punojnë bashkë në një rol. P.sh. një person mund të jetë Hulumtues dhe Skenarist, dhe/ose mund të ketë dy Producentë etj.

Një ekip i thjeshtë i përbërë nga katër persona mund të përfshijë një Drejtor/Producent, një Hulumtues/Skenarist/Artist i Tregimit Vizual, një Kameraman/Zërues, dhe një Redaktor/Operues të Efekteve Speciale.

Educational Technology Resources ©2002 Grossmont Union High School District

Planifikimi

Hapi 1: Diskutimi i idesë së projektit: Nxënësit duhet ta shkruajnë propozimin e tyre dhe të jenë të gatshëm të shpjegojnë se si mendojnë ta arrijnë rezultatin përfundimtar. Është shumë me rëndësi që mësime të mësimdhënësit ta lexojë propozimin me kujdes (të kontrollojë drejtshkrimin, mënyrën e prezantimit e të tjera), të takohet me grupin dhe sipas vlerësimit, të përkrahë ose të kërkojë modifikime të propozimeve të nxënësve. Refuzimi i projekteve dhe modifikimi i propozimeve ndodh shpesh në botën e filmit dhe të kinematografisë. Vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Drejtorit Ekzekutiv (mësime të mësimdhënësit), nxënësit mund të fillojnë punën në projektin e tyre.

Hapi 2: Hulumtimi për Projektin – Nxënësit duhet të zhvillojnë hulumtime për t'u siguruar që videoja e tyre të përfshijë informata të besueshme. Si pjesë e videos së tyre, ata duhet të përfshijnë gjithmonë referenca të qarta apo Punimet e Cituara duke iu referuar dokumenteve apo burimeve prej nga janë marrë faktet.

Hapi 3: Shkruarja/Rishikimi i Skenarit – Varësisht nga stili i videos, nxënësve mund t'u lindë ose jo nevoja për kompletimin e skenarit para filmimit. Për shembull, një video që mbron një tematikë të caktuar dhe ku shprehen opinione apo mendime të ndryshme, mund të ketë dialogje të cilat duhen shkruar para xhirimeve. Një tekst i bazuar në hulumtime mund të përdoret për rrëfim të mbivendosur apo për titra të bazuar në fakte të cilat shfaqen në ekran gjatë procesit të redaktimit. Përmbytja e shkruar natyrisht që duhet përshtatur me videotregimin dhe filmimin.

Hapi 4: Videotregimi – Pas miratimit të projektit, nxënësit e tregojnë ngjarjen në mënyrë vizuale, pamje pas pamjeje, në formën e duhur të videotregimit. Nxënësit mund të krijojnë videotregime

⁸ Adobe – Udhërrëfyese Qendror i Dizajnit: Redaktimi i stilit të videotregimit (Design Center Tutorial: Edit storyboard style) Nëse keni softuerin Adobe Premiere mund të përdorni dritaren e projektit për të organizuar videoklipet në format të tregimit vizual.

edhe nëse nuk bëjnë asgjë tjetër veçse vizatojnë skica të ndryshme që e tregojnë ngjarjen në formë vizuale. Secila sekuençë filmike (klip) duhet të emërtohet me një numër rendor në qoshen e majtë lart të dritares, duhet të selektohen pamjet, dhe duhet të shkruhet një përshkrim i hollësishëm i vendosur në fund të çdo dritareje ku shpjegohet se çfarë ndodh në atë sekuençë filmike. Drejtori Ekzekutiv duhet t'i kontrollojë videotregimet para se nxënësit të fillojnë me Hapin 5.

Produksioni

Hapi 5: Filmimi – Pasi puna paraprake të jetë miratuar nga Drejtori Ekzekutiv, nxënësit duhet të fillojnë t'i kontrollojnë pajisjet dhe ta filmojnë projektin. Nxënësit mund të sajojnë mjete konkretizimi, mund të punojnë me kostumet, apo mund të mbledhin burime të ndryshme që duhen për projekt, si p.sh. pjesë muzikore për t'i përdorur në projekt. Është shumë me rëndësi që nxënësit të udhëzohen lidhur me përdorimin e duhur të video-pajisjeve dixhitale. Varësisht nga zgjedhja dhe miratimi i mësimdhënësit, disa projekte mund të kenë nevojë për përdorim të pajisjeve jashtë ambienteve shkollore. Mësimdhënësit duhet ta organizojnë këtë me administratën.

Shënim: Prindërit duhet t'i nënshkruajnë lejet për punën e nxënësve në këto projekte dhe shkolla duhet t'i ruajë këto leje. Koordinoni përdorimin e pajisjeve me grupet e tjera në klasën tuaj në mënyrë që secili grup të ketë qasje të barabartë në pajisje për projektet e tyre. Ua kujtoni nxënësve që të filmojnë disa sekonda para dhe disa sekonda pas videos së dëshiruar për të lënë vend për tranzicionet më vonë gjatë procesit të redaktimit (editimit).

Fleta me Këshilla për Redaktimin e Videos

Planifikimi

- Mendoni se çfarë doni që shikuesi (spektatori) të 'fitojë' nga videoja juaj. Shkruani rreth 4-5 mësim kryesore apo porosi për shikuesit.
- Përdorni videotregimin që të hartoni videon tuaj dhe të siguroheni që po i arrini rezultatet e dëshiruara të të nxënit.
- Sigurohuni që i keni të gjitha mjetet e konkretizimit që ju duhen, materialet apo pajisjet për skenat që doni t'i xhironi.

Tregimi i ngjarjes

- Tregojeni ngjarjen shkurt. Mendoni se si t'i ndani ngjarjet më të gjata në pjesë më të shkurtra.
- Sigurohuni që mesazhi juaj të dalë i qartë.
- Kapni dhe mbani vëmendjen e publikut. Provoni të filmoni nga kënde dhe distanca të ndryshme.
- Tregimi juaj duhet të jetë relevant dhe duhet të ketë kuptim për jetët e anëtarëve të publikut tuaj.
- Gjithmonë duhet të ketë një fillim, një mes, dhe një fund.

Cilësia e videos

- Mos filmoni direkt përballë diellit, sepse do të errësohet videoja.
- Flip kamerat janë të ndjeshme ndaj lëvizjes. Përdorni një trekëmbësh ose mbajeni kamerën fort duke shtrënguar të dy krahët.
- Në vend që të përdorni fokusimin dixhital, afrohuni tek objekti i filmimit tuaj. Kështu do të duket më natyrshëm.

Cilësia e zërit (audio)

- Mikrofoni i flip kamerës është shumë i ndjeshëm. Kujdes kur filmoni jashtë në natyrë apo në ambiente të zhurmshme – kamera kap shumë zhurmë nga sfondi përreth.
- Sa më afër objektit të filmimit të jetë kamera, aq më e mirë do të jetë cilësia e zërit.

Redaktimi (editimi)

- Para se të filloni redaktimin, organizoni një sistem emërtimi dhe dokumentimi për të gjitha sekuenat tuaja filmike (klipet).
- Gjithmonë sigurohuni t’i ruani me ‘Save As’ nëse ndryshoni një klip origjinal.
- FlipShare lejon vetëm titrat hapëse dhe ato mbyllëse. Nëse doni të përdorni titra në ekran para klipeve të veçanta, shfrytëzoni opsionin ‘Create a Movie’ (krijoni filmin) duke përdorur vetëm klipin në fjalë. Më pas mund të përdorni klipin e ri me titra në videon finale.
- FlipShare automatikisht përdor një fazë tranzicioni mes çdo klipi. Sigurohuni që të keni një sekondë kohë të ndërmjetme në fillim dhe në fund të çdo klipi në mënyrë që asgjë të mos mbetet jashtë gjatë tranzicionit.
- Për redaktim më të sofistikuar, përfshirë edhe krijimin e nën-titrave, nivelizimit të zërimit, si dhe tranzicione të ndryshme, provoni ta përdorni programin Windows MovieMaker.
- Mund të lindë nevoja për konvertimin e videove MP4 në formatin WMV para se të përdorni Windows MovieMaker. Për këtë shfrytëzoni FormatFactory, një program gratis për konvertimin e dokumenteve.

Premiera paraprake

- Shumë producentë të kinematografisë vendosin të bëjnë një paraqitje paraprake të filmave të tyre, përpara se ata të shfaqen para publikut të gjerë. Mbase edhe ju mund të mblidhni një grup të vogël njerëzish që përfaqësojnë publikun tuaj dhe ta shfaqni filmin para tyre.
- Kërkoni mendimet e tyre. Çfarë u ka pëlqyer? Çfarë nuk u ka pëlqyer? A kanë mësuar ato që ju doni t’ua mësoni?
- Përdorni mendimet dhe kontributin e tyre për të bërë ndryshime në ngjarjen apo videon tuaj.

Shpërndarja (distribuimi)

- FlipShare ju lejon të shkarkoni videon tuaj direkt në YouTube apo në ndonjë faqe tjetër Interneti.
- Mendoni për mënyra të tjera se si mund ta shpërndani videon tuaj dhe veproni në atë drejtim. A do ta shfaqni videon në shkollë? A do ta incizoni në CD për ta shpërndarë?

Shënime:

10. A ju pengon që nxënësit kalojnë shumë kohë në internet?

10.1 KOMUNITETET E TË NXËNIT - DISA NGARRJETET SOCIALE

Sot në internet ekzistojnë rrjete të shumta sociale (si Facebook, Twitter, LinkedIn etj.) të cilat janë themeluar për qëllime të ndryshme komerciale ose jokomerciale. Këto rrjete shërbejnë për shkëmbimin e informatave personale dhe të mendimeve në mes të personave të ndryshëm që u bashkohen këtyre rrjeteve. Është interesant se pos funksionit të vet social, këto rrjete mund të përdoren edhe për të nxënë, për komunikim, për prezantime, për krijim të grupeve të të nxënësve, për shqyrtim të temave të ndryshme, e të tjera. Në këtë kuptim, sidomos në funksionin e komunikimit, këto rrjete ofrojnë mundësi të pakufishme për përdorim të gjuhës angleze qoftë me individë apo me grupe më të mëdha / rrjete. Pos këtyre funksioneve, rrjetet sociale mund të ofrojnë platformë të pazëvendësueshme edhe për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe shkëmbim të përvojave me kolegët e vet në mbarë botën. Krijimi e mirëmbajtja e portfoliove (dosjeve), portreteve e praktikave të mira, si dhe reflektimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira me kolegë janë vetëm disa përparësi të këtyre rrjeteve. Me një përdorim të strukturuar e të organizuar mirë, rrjetet sociale e lehtësojnë dukshëm edhe komunikimin në mes të mësimdhënësve, por edhe në mes tyre dhe nxënësve të tyre. Në vijim po japim disa prezantime të shkurtra të disa rrjeteve më të njohura sociale dhe përdorimeve të tyre të mundshme për mësimdhënien dhe të nxënësve të gjuhës angleze.

1. FACEBOOK

Facebook është një shërbim social i rrjetëzimit dhe një uebfaqe që ishte lansuar në shkurt 2004, në pronësi të Facebook, Inc. Prej korrikut 2011, Facebook-u ka më shumë se 750 milionë përdorues aktivë. Përdoruesit mund të krijojnë një profil personal, të shtojnë përdorues të tjerë si miq dhe të shkëmbejnë mesazhe, përfshirë njoftime automatike në rastet kur e përditësojnë profilin e vet. Përdoruesit e Facebook-ut duhet të regjistrohen para se ta përdorin faqen. Pos kësaj, ata mund t'u bashkohen grupeve të përdoruesve me interesa të përbashkëta, të organizuara në vendin e punës, në shkollë ose në kolegje, ose sipas karakteristikave të tjera. Emri i këtij shërbimi rrjedh nga emri i zakonshëm që u jepet studentëve në administratën e universiteteve në SHBA në kohën kur i regjistrojnë studimet – me qëllim që t'u ndihmojnë atyre ta njohin njëri tjetrin më mirë. Facebook-u u mundëson të gjithë përdoruesve në moshën mbi 13 vjeç që të regjistrohen dhe ta përdorin uebfaqen.



KËSHILLË PËR MËSIMDHËNËSIT: bëni një lundrim nëpër Facebook. Aty mund të organizoni edhe uebfaqet tuaja dhe të organizoheni në grupe të ndryshme me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies tuaj. Mundësitë janë të panumërta. Për shembull, asociacioni i mësimdhënësve të gjuhës angleze mund të organizojnë një grup të vetin për shkëmbim të përvojave e praktikave të mira.

2. TWITTER

Twitter është një uebfaqe, e cila ofron shërbime për rrjetëzim social dhe shkëmbim të mendimeve (mikrobllogim), duke u mundësuar shfrytëzuesve të dërgojnë dhe lexojnë porosi të quajtura 'tweets' (prej anglishtes cicërime). Tweets janë postime të teksteve deri në 140 shkronja e që paraqiten në faqen e profilit të shfrytëzuesit.



Twitter është prodhuar në mars të vitit 2006 nga Jack Dorsey dhe është lansuar në korrik. Që atëherë Twitter ka fituar popullaritet në tërë botën dhe vlerësohet se i ka 200 milion shfrytëzues, që i gjeneron 200 milion 'tweets' në ditë dhe i mirëmban mbi 1.6 miliardë kërkime në ditë. Ndonjëherë përshkruhet si "SMS e internetit". Në mësimdhënien dhe të nxënit e gjuhës angleze, Twitter mund të përdoret për dërgimin e mesazheve të shkurta për përvoja të

ndryshme në mësimdhënie, informata kthyesë për punën e nxënësve, ndarje të detyrave, mesazhe të shpejta në mes të nxënësve lidhur me detyrat, e të tjera.

3. MYSPACE



Myspace ('hapësira ime') u bë faqja më e popullarizuar e rrjetëzimit social në Shtetet e Bashkuara në qershor 2006, dhe vazhdoi kështu deri në vitin 2008. Rreth prillit të vitit 2008, sipas burimeve nga comStore, vendin e


Myspace e zuri rivali kryesor Facebook, në bazë të vizitave ditore nga përdoruesit. Nga ajo kohë Myspace ka qenë në rënie të vazhdueshme, pavarësisht nga ridizajnimet e shumta e shpesh drastike. Sipas vlerësimeve të Quantcast-it, numri i vizitorëve të përditshëm në Myspace në maj 2011 ishte 19.7 milionë. Në korrik 2011 Myspace renditej në vendin e 85-të, në krahasim me vendin e dytë që mbahej nga Facebook.

4. KELT – SHEMBULLI 2


<http://bep-ks.org/connect/groups/teacher-training/kosovo-english-language-teachers-kelt/>

Në kuadër të projektit Basic Education Program është zhvilluar edhe webfaqja e projektit, që përmban edhe Platformën CONNECT. Në kuadër të platformës janë krijuar disa grupe. E njëri nga këta është KOSOVO ENGLISH LANGUAGE TEACHERS – KELT. Ky rrjet do të jetë në shërbim të fasilitatorëve të Basic Education Program dhe mësimdhënësve të gjuhës angleze që realizojnë aktivitetet e kursit të gjuhës angleze të Basic Education Program. Të gjithë mësimdhënësit që lidhen me këtë platformë përfitojnë të gjitha shërbimet e ofruara nga Basic Education Program: materiale të kursit për përdorimin e teknologjisë informative në mësimdhënien dhe në të nxënit e gjuhës angleze, përgjigje në të gjitha pyetjet e mësimdhënësve dhe këshilla nga kryefasilitatori 'kujdestar' i Basic Education Program, këshilla për përdorimin e resurseve 'online', mundësi për vizitë të kryefasilitatorit (ose e fasilitatorëve tanë shkollorë të gjuhës angleze) në shkollën tuaj për përkrahje në zbatimin e aktiviteteve të kursit, përfshirë edhe "videotregimin", huazimin e teknologjisë arsimore sipas kërkesave tuaja (përfshirë edhe 'flip-kamerën'), mundësi për shkëmbimin e mendimeve me kolegë të tjerë të lidhur në platformë, shfrytëzimin e listës së adresave online e të tjera. Platforma ofron edhe qasje dhe vegëza në platforma e banka të tjera të burimeve për mësimdhënien e gjuhës angleze.


Më poshtë do t'ju prezantojmë se si ne mund të jemi pjesë e kësaj Platforme. Së pari, duhet të krijohet një shfrytëzues i ri – duke klikuar në **create an account**.




Pastaj duhet të plotësohen të dhënat që kërkohen. Të dhënat që shkruhen aty duhet të jenë të sakta. Gjithashtu, në këtë faqe ju mund edhe të përcaktoheni se në cilin grup doni të anëtarësoheni.



Pamja e faqes së grupit duket kështu. Aty janë të renditura menytë dhe nën-menytyt tjera: Dokumentet, Forumi, Anëtarët.



Më poshtë paraqiten dokumentet e prodhuara nga trajnimet me mësimdhënësit e gjuhës angleze. Secili pjesëmarrës mund ta paraqes punën e vet në këtë platformë. Në këtë mënyrë, përveç prezantimit të punës kjo na ndihmon edhe në shkëmbimin e përvojave, pastaj në vlerësimin e punës dhe çka është më e rëndësishme nxit komunikimin me të gjithë kolegët e fushës së njëjtë.



Për përdorimin e kësaj platforme, si edhe të rrjeteve e burimeve të tjera sociale në internet, të gjithë pjesëmarrësit duhet ta kenë nga një kompjuter në dispozicion. Në fillim është mirë që një person me përvojë ta demonstrojë përdorimin e platformës edhe pse ajo mund të përdoret edhe nëse përfillen udhëzimet e dhëna nga administratori. Pos kësaj, është mirë që secili mësimdhënës të hapë një adresë të veten për përdorim të kësaj platforme⁹.

**A dëshiron t’u ndihmosh nxënësve t’i zhvillojnë kompetencat që u duhen për të ardhmen?
– Atëherë ndihmoju të jenë selektiv në marrjen e informatave!**

5. WEBQUEST & BURIMET NGA INTERNETI



Webquest (“kërkim-në-rrjet”) është një aktivitet gratis nga Interneti, i cili bazohet në hulumtime dhe në të nxënë online. Ky aplikacion softuerik mund të përdoret për qëllime të ndryshme në mësimdhënien dhe në të nxëniet e gjuhës angleze. Aty mund të gjeni informacione për tema nga më të ndryshmet, aktivitete ndërvepruese, ilustrime të ndryshme, materiale për zhvillimin e mësimin e të tjera. Për ilustrim të mundësive që ofron ky aplikacion, KEC-i ka zhvilluar një aktivitet të tërë me temën e Multikulturalitetit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë me përqëndrim në vendet dhe popujt që flasin gjuhën angleze si gjuhë amtare.

Edhe ju mund ta zhvilloni këtë aktivitet edhe pa ndonjë aftësim paraprak. Ju mjafton t’i keni motivuar si duhet nxënësit dhe të keni në dispozicion një ose më shumë kompjuterë me qasje në internet (alternativë: një pjesë e hulumtimit zhvillohet në shtëpi). Puna në zbatimin e këtij aktiviteti është individuale dhe grupore dhe përbëhet nga hulumtime dhe nga prezantime të ndryshme. Kësisoj zhvillohen shkathtësi të shumta të nxënësve, si puna ekipore, kërkimi dhe përpunimi i informacionit, prezantimi, shkëmbimi i mendimeve e të tjera.

5.1 ILUSTRIM I NJË AKTIVITETI NË WEBQUEST

Përshkrim i aktivitetit:

Gjatë këtij aktiviteti nxënësit punojnë në grupe, duke i ndarë detyrat mes tyre në mënyrë të atillë që secili merr pjesë dhe ka një rol në punën grupore. Në këtë aktivitet shumica e informacionit të përdorur nga nxënësit është online. Duke ia dhënë vegëzat nga Interneti që nevojiten për zhvillimin e këtij aktiviteti, nxënësi arrin të përqendrohet në materialin e duhur dhe nuk harxhon kohë duke e kërkuar këtë material në rrjet.

Kjo nënkupton që është mësim që zhvillohet në klasë (ose, një pjesë, edhe në shtëpi), ku i tërë informacioni, ose pjesa më e madhe e informacionit që nxënësit eksplorojnë dhe vlerësojnë vjen nga Interneti.

⁹ Shih artikullin “Dhënia dhe marrja konstruktive e informatave kthyesë” në seksionin për Lexim të mëtejshëm në fund të këtij doracaku

Vendet ku Flitet Gjuha Angleze – Ekonomia & Tregtia

Hyrje:

Anglishtja është ndër gjuhët më të folura në botë (gjuhët e tjera më të folura janë mandarin, spanjisht, hindi, dhe arabisht). Anglishtja ka dalë si gjuhë jetike për komunikimet globale lidhur me fushat e biznesit, shkencës, diplomacisë, aviacionit dhe teknologjisë informative.

Tani anglishten e flasin mbi 1 miliard njerëz anë e kënd botës. Dhe, ashtu siç mund të pritet, ka ngjashmëri të shumta në përdorimin e anglishtes si dhe në doket e shumë vendeve ku flitet gjuha angleze. Po aq interesante janë edhe dallimet që ekzistojnë mes varianteve të anglishtes në vende me kultura të ndryshme angleze. Ky aktivitet i të nxëniet u jep mundësi pjesëmarrësve t'i zbulojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes kombeve në mënyrë bashkëpunuese.

Detyra: "Hulumtimi i kulturave anglishtfolëse"

Është viti 4011. Ju jeni drejtor muzeu në planetin Venus dhe po niseni për një udhëtim në Tokë, shumë kohë pas një aktiviteti gjigant vullkanik që ka shkaktuar evakuimin e të gjithë banorëve të Tokës para 1000 vjetësh. Aktiviteti vullkanik është shuar dhe ekipi juaj ka marrë leje për të udhëtuar drejt Tokës për të mësuar lidhur me kulturat e ndryshme anglishtfolëse që dikur jetonin në Tokë.

Një ekip hulumtues ka përcaktuar që katër vendet e mëposhtme kanë pasur popullatën më të madhe anglishtfolëse me anglishten si gjuhë amtare:

1. Shtetet e Bashkuara të Amerikës
2. Mbretëria e Bashkuar
3. Kanadaja
4. Australia

Muzeu juaj, Muzeu Ndërplanetar i Anglishtes Antike, do të organizojë një ekspozitë në katër salla kryesore me temat Ushqimi & Pija, Sporti & Argëtimi, Ekonomia & Tregtia, Historia & Gjuha. Ekipi juaj është zgjedhur për mbledhjen e informacioneve dhe artikujve apo objekteve të ndryshme për t'u përfshirë në pjesën e ekspozitës **Ekonomia & Tregtia**.

Procesi:

Ju lutem përdorni hapat e mëposhtëm për kryerjen e detyrës suaj:

Hapi 1: Ndahuni në ekipe/grupe.

Hapi 2: Vizitoni faqet e Internetit të renditura dhe mblidhni informacion që mund ta përfshini në ekspozitën tuaj.

Pyetjet e mëposhtme ju ndihmojnë në eksplorimin tuaj për vendet e renditura më lart:

- Cilat janë eksportet më të mëdha të vendeve të lartpërmendura?
- Cilët janë partnerët më të ngushtë të tregtisë?
- Cila valutë përdoret nga secili vend? Çfarë vlere ka secila valutë?
- Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet mes vendeve anglishtfolëse në aspektin e Ekonomisë & Tregtisë?

Informacione të përgjithshme

- Fjala “Dollar” dhe shenja e dollarit \$
<http://projects.exeter.ac.uk/RDavies/arian/dollar.html>
- Konvertuesi i Valutave
<http://www.translatorscafe.com/cafe/tools.asp?pn=currency>

Shtetet e Bashkuara:

- Eksportet kryesore të SHBA-ve në botë
http://www.worldsrichestcountries.com/top_us_exports.html

Mbretëria e Bashkuar:

- Eksportet dhe importet e MB-së në vitin 2009: produktet kryesore dhe partnerët kryesor tregtarë
<http://www.guardian.co.uk/news/datablog/2010/feb/24/uk-trade-exports-imports>

Kanadaja:

- Pesë eksportet kryesore të Kanadasë në SHBA
<http://www.top5ofanything.com/index.php?h=1001a7c3>

Australia:

- Eksportet kryesore australiane
<http://seekingalpha.com/article/149673-top-australian-commodity-exports>
- Partnerët reciprokë të Australisë në tregëtinë e produkteve dhe shërbimeve dhe eksportet kryesore të Australisë
http://www.dfat.gov.au/trade/focus/081201_top10_twoway_exports.html

Hapi 3: Shqyrtoni informacionin e dhënë në faqet e internetit dhe punoni me ekipin tuaj për të vendosur se cilat informata do t’i përfshini në ekspozitën tuaj (nuk mund t’i përfshini të gjitha!).

Hapi 4: Mblidhuni me grupet e tjera për t’i prezantuar materialet/artikujt tuaj. Edhe për këtë hap mund t’i shfrytëzoni materialet tona për dhënien dhe marrjen konstruktive të informatave kthyesë.

Shënime:

6. DHJETË KËSHILLA TË MIRA PËR PËRDORIMIN E MEDIAVE SOCIALE NË KOMUNIKIMET SHKOLLORE

i. Përdorni rrjetet sociale si mjet hulumtimi.

Mediat sociale janë të lehta për t'u përdorur dhe shumica e tyre shfrytëzohen pa pagesë. Edhe nëse nuk bëni asgjë tjetër, të paktën shihni se çfarë thonë të tjerët për ju, për shkollën tuaj dhe për punën tuaj.

ii. Së pari detyrat e shtëpisë.

Gjeni nëse shkolla apo qyteti juaj ka ndonjë politikë apo rregull lidhur me përdorimin e rrjeteve sociale në Internet nga punonjësit. Sigurohuni që gjithçka që bëni online të jetë në përputhje me këto rregulla dhe me politika dhe procedura të tjera relevante, si dhe me ligjet apo rregulloret e shtetit që qeverisin personelin shkollor dhe përdorimin e pranueshëm të teknologjisë.

iii. Filloni me një faqe Interneti dhe vazhdoni më tej.

LinkedIn, Facebook, YouTube, Twitter, WordPress, TeacherTube: zgjidhni njëren prej tyre dhe filloni të postoni gjëra. Përditësojeni të paktën një herë në ditë. Sa kohë mund të marrë shtypja e 140 karaktereve?

iv. Bëjeni zyrtare.

Përdorni mediat sociale si zgjerim i jetës suaj profesionale dhe si mënyrë shtesë për të ndarë informata të rëndësishme me publikun tuaj kyç dhe me grupet e interesit. Krijoni një faqe zyrtare. Përfshini stemën apo simbolin e shkollës apo qytetit tuaj, si dhe vegëza drejt faqeve të Internetit të organizatës suaj dhe faqeve zyrtare të mediave sociale.

v. Jini transparent.

Identifikohuni si punonjës i shkollës në faqen tuaj të Internetit ose kur u përgjigjeni të tjerëve. Kini parasysh që çdo mendim që shprehni është mendimi juaj dhe atë duhet ta shprehni në mënyrë të përshtatshme.

vi. Mbajeni jetën personale të ndarë nga jeta juaj profesionale.

Mos lidhni miqësi me nxënës apo me prindër apo mos i lidhni ata me faqen tuaj personale në Internet. Lejoni nxënësit tuaj dhe prindërit e tyre të kenë qasje në postimet tuaja profesionale online. Çdo gjë që është e papërshtatshme për në klasë apo për lajmet e mbrëmjes është po ashtu e papërshtatshme edhe për t'u postuar online.

vii. I thoni një miku ta kontrollojë drejtshkrimin tuaj.

Mësimdhënësit edukatorë u përmbahen standardeve më të larta kur vjen puna tek gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore, përdorimi dhe zgjedhja e drejtë dhe e përshtatshme e fjalëve. Kini kujdes që ta përfaqësoni mirë profesionin e edukatorit – dhe në një mënyrë që i frymëzon të tjerët t'i përkrahin shkollat publike dhe nxënësit e tyre.

viii. Shkruani si prind apo si person i zakonshëm, jo si edukator.

Rrjetet e mediave sociale ofrojnë mundësi të shumta për t'i bërë më njerëzorë 'individët e frikshëm' siç janë mësuesit, punonjësit social, këshilltarët, drejtorët, dhe kujdestarët. Ruani tonin e bisedës dhe mos përdorni terma të tilla si "mësimi i individualizuar" apo "vlerësimi autentik". Thoni atë që mendoni duke përdorur fjalë të përditshme dhe të thjeshta me fjali të drejtpërdrejta.

ix. Tregoni kujdes dhe dashuri.

Prindërit dhe aktorët e tjerë të fushës së arsim-edukimit duan të dinë që ju kujdeseni për fëmijët dhe i doni ata. Mos kini frikë të tregoni pasion për punën që bëni dhe për fëmijët të cilëve u shërbeni. Ka një logjikë në faktin se rrjetet sociale përdorin fjalë si "mik/mikeshë" apo "shok/shoqe" (Angl. friend), "fans", "pëlqej" (Angl. like), "ngacmoj" (Angl. poke) dhe "lidh" (Angl. connect). Ideja është që të krijohen lidhje mes njerëzve në mënyra të reja dhe jo-kërcënuese.

x. Ruani privatësinë e të tjerëve.


Tregimi i ngjarjeve të ndryshme që u kanë ndodhur vërtet nxënësve në klasë, në shkollë dhe në qytet nuk do të thotë se duhet të jepni hollësi personale të identifikueshme siç janë emri dhe mbiemri, vendi i saktë i punës, pozita, adresa, numri i telefonit, paga, apo informata të tjera që mbrohen nga shteti dhe ligjet mbi privatësinë.

Autorja e artikujve në eSchool News (lajmet shkollore online) Nora Carr, fituese e disa çmimeve, është drejtoreshë e stafit të Shkollave të Krahinës Guilford.



7. EFL CLASSROOM 2.0

Ligjëratë / Demontrim / Bashkëpunim

 25 min.

EFL CLASSROOM 2.0 – SHEMBULLI 1

<http://community.eflclassroom.com>

EFL CLASSROOM 2.0 është një platformë që ofron mundësi të panumërta për të gjithë shfrytëzuesit. Ajo ka diku rreth 23 mijë anëtarë të cilët kontribuojnë në pasurimin e saj me materiale të ndryshme që i shërbejnë mësimdhënies/mësimnxënies. Mund të konsiderohet si një burim i pashtershëm i informacionit për të gjithë mësimdhënësit, andaj ne do të shkojmë hap pas hapi për të treguar se si mund të kemi qasje në të.

Së pari duhet të krijojmë një llogari të re / shfrytëzues i ri (shiko foton)



Plotëso të dhënat që kërkohen, të dhënat duhet të jenë të sakta (shiko foton).

10.2 Dhënia dhe pranimi i komenteve efektive: Udhërrëfytes për vetëvlerësimin përmes kolegëve

Hyrje

Një nga kontributet më të çmuara që mund të jepet në procesin e të nxënës është komenti konstruktiv. Si mësimdhënësi, ashtu edhe nxënësi e kanë kapacitetin t'i japin tjetrit informata të dobishme të cilat ndihmojnë që të nxënës të jetë më efektiv.

Kur i jepni dikujt komente mbi punën e tij/saj nënkupton që keni aq konsideratë për atë person sa që shpenzoni kohën tuaj për të shqyrtuar punën e tij/saj dhe që kjo punë vlen ta ketë vëmendjen tuaj. Kjo mënyrë e vlerësimit e personit në fjalë dhe i ofron atij/asaj mendimin tuaj lidhur me punën që tjetri është përpjekur ta kryejë.

Çdokush e ka mundësinë të japë komente të dobishme, por disa njerëz e përdorin më efektivisht se të tjerët. Shkathtësia e të dhënës dhe pranimit të komenteve mund të zhvillohet nëse u kushtohet vëmendje disatributeve që ia vlejné, dhe nëse bëhet në mënyrë të atillë që e rrit kontributin në të nxënës.

Komentet e mira dhe të këqija

Para se t'i hyjmë me hollësi komenteve të dobishme, është me rëndësi të dallojmë ato lloje komentesh që janë të padobishme, e nganjëherë vërtet të dëmshme. Ne e dimë si është kur pranojmë komente që na bëjnë të ndihemi 'të ngacmuar', 'të sulmuar', 'të poshtëruar', 'të mallkuar', dhe përgjithësisht të zhvlerësuar personalisht. Disa nga tiparet themelore të komenteve të këqija kanë të bëjnë me faktin se drejtohen universalisht kundër personit; kjo është e padobishme, sepse nuk sugjeron se si duhet të ishte; është paragjyquese, meqenëse buron nga nevojat e kritikut më shumë se nga personi që e pranon komentin; dhe mund të shkaktojë një barrë shkatërruese nga e cila është vështirë të dilet: është thjesht jo njerëzore.

Komentet e dobishme, nga ana tjetër, e rikonfirmojnë vlerën e personit dhe ofrojnë përkrahje ndërkohë që shprehin reagimet ndaj objektit të vëmendjes. Kështu, personi që jep komente tregon që e vlerëson personin që i pranon komentet, e po ashtu tregon që komentdhënësi është i ndjeshëm ndaj nevojave dhe qëllimeve të komentpranuesit. Kjo nuk do të thotë se duhet të jepen vetëm lëvdata; në fakt, lavdërimet false apo lavdet për vetë personin më shumë se sa për punën e tij/saj mund të jenë mjaft kundërproduktive – mund të krijojnë ndjesinë e marrjes në mbrojtje apo të kontrollit. Megjithatë, çdo çështje kritike duhet të ngrihet në kontekst të përkrahjes së plotë ku të gjitha palët kanë besim te njëra-tjetra.

Komentet e dobishme bëjnë dallimin e ndërgjegjshëm mes personit – i cili gjithmonë vlerësohet – dhe veprimit apo punës së dhënë – që mund t'i nënshtrohet komenteve apo kritikave. Ky dallim thekson që personi nuk është identik me atë që bën, dhe që puna apo veprimet e tij/saj nuk janë e njëjta gjë me personin në fjalë, por kjo nuk duhet të përdoret nga askush si justifikim për mosmarrjen përsipër të përgjegjësisë për sjelljen e vet. Pa marrë parasysh sa të pahijshme mund të jenë veprimet e një personi, komentet mund të kenë efekt vetëm kur respektohet qenia njerëzore në vetvete.

Dhënia e Komenteve

Në diskutimet e mëposhtme përdoret fjala 'punë' apo 'kontribut' për të përshkruar çështjen mbi të cilën jepen komente. Kjo 'punë' mund të jetë e çfarëdo lloji: ese, kontribut i dhënë në klasë, dizajn, një sjellje e caktuar, projekt në formë të ndryshme si me shkrim, me gojë, në formë grafike etj.

Ka shumë tipare të komenteve të vlefshme, por më i rëndësishmi prej tyre ka të bëjë me mënyrën se si jepen ato komente. Toni, stili dhe përmbajtja duhet të jenë konsistente (të qëndrueshme) dhe duhet të përcjellin porosinë (mesazhin) e vazhdueshme: 'Të vlerësoj ty dhe atë që ke bërë, dhe çdo gjë tjetër që them duhet të merret në të njëjtin kontekst'. Nëse dëshironi të jepni komente të vlefshme dhe të dobishme, atëherë:

- **Jini realist**

Orientojini komentet drejt çështjeve mbi të cilat personi mund të veprojë. Mos bëni sugjerime që janë krejtësisht jashtë mundësive të personit. Komentet konstruktive mund të jenë të dobishme për sa kohë që respektojnë mënyrën individuale se si tjetri i bën gjërat.

- **Tregohuni specifik**

Përgjithësimet janë posaçërisht të padobishme. Bazojini komentet mbi sjellje apo materiale konkrete dhe të vëzhgueshme. Gjithmonë mendoni për veçorinë e përshtypjes apo konkluzionit tuaj, dhe përdoreni këtë veçori në përgjigjen tuaj. Fokusimi tek sjellja nënkupton që ka diçka lidhur me një situatë të caktuar e cila mund të ndryshohet. Personit duhet t'i jepet informacion i mjaftueshëm për të qenë në gjendje të diktojë pjesët të cilave po i referoheni dhe ta ketë të qartë se çfarë po thuhet për pjesët në fjalë. Jepni shembuj.

- **Tregohuni i ndjeshëm ndaj qëllimeve të personit**

Fakti që kontributi i personit nuk i ka përmbushur qëllimet tuaja nuk nënkupton domosdoshmërisht që diku është gabuar. Personi ka përgatitur një punë për një qëllim të caktuar, dhe ju duhet të jeni i vetëdijshëm për këtë qëllim në mënyrë që të shprehni pikëpamjet tuaja në përputhje me të. Kjo nuk do të thotë që nuk mund të bëni komente nga këndvështrimi juaj por që duhet të jeni i qartë kur parashtroni pikëpamje që burojnë nga qëllimet tuaja, në ç'rast duhet ta shpjegoni një gjë të tillë. Bëjeni lidhjen mes komenteve tuaja dhe qëllimeve të tyre; dëgjoni me kujdes se çfarë kanë për të thënë. Nëse ka ndonjë detyrë të përbashkët, sigurohuni që të ketë një interpretim të dyanshëm lidhur me atë çka nënkupton një detyrë e tillë.

- **Gjeni momentin e duhur**

Kaktoni kohën e duhur për dhënien e komenteve. Nuk ia vlen të ofroni komente pasi personi pranues e ka përmbyllur punën dhe ka filluar një punë tjetër. Përgjigjuni menjëherë kur kërkohet komenti juaj: për të qenë efektiv, komenti duhet të jepet në kohën e duhur.

- **Përshkruani mendimet**

Jini përshkrues në shprehjen e pikëpamjeve tuaja. Mos vlerësoni dhe mos thoni se çfarë mendoni se duhet të ndiejë tjetri. Mos manipuloni me emocione: po paraqisni pikëpamjet dhe konsideratat tuaja të cilat duhet të kenë tiparet e përmendura këtu; pastaj personi e ka në dorë vetë nëse vendos t'i pranojë apo t'i refuzojë ato.

- **Bëhuni paparagjykues me vetëdije**

Ofroni mendimin tuaj personal; mos veproni si autoritet edhe nëse diku tjetër mund të jeni në pozitë të tillë. Shprehni reagimet dhe ndjenjat tuaja më shumë sesa deklaratat e ngarkuara me vlera. Një mënyrë për ta bërë këtë është përdorimi i komenteve të tilla si 'ndihem... kur ti...'

- **Mos bëni krahasime**

Trajtojeni punën e secilit si puna e vet, jo si pjesë e një gare të supozuar me të tjerë. Bëni kujdes në dhënien e komenteve aty ku mendimet që shprehni për pranuesin në fjalë mund të krahasohen me mendimet që shprehni për dikë tjetër. Krahasime të tilla mund të dëmtojnë motivacionin e brendshëm.

- **Jini i zellshëm**

Kontrolloni përgjigjen tuaj. A është pasqyrim i saktë i asaj që doni të shprehni? A e keni perceptuar si duhet kontributin? Nuk ka asgjë më bezdisëse se pranimi i kritikave nga dikush i cili shihet qartë se nuk është lodhur fare t'i kushtojë vëmendje asaj që keni bërë.

- **Jini i drejtpërdrejtë**

Thoni atë që mendoni. Mos e mbështillni mendimin me fjalë të mëdha e të panevojshme apo me gjuhë abstrakte.

- **Jini pozitiv**

Thoni se çka është ajo që çmoni. Mos u fokusoni vetëm tek ato gjëra që ju shkaktojnë reagim negativ. Përpiquni të gjeni diçka që ka ndjenjë të vërtetë brenda, në vend që të gjeni diçka që është pozitive thjesht sepse mendoni se kështu duhet vepruar.

- **Jini i vetëdijshëm**

Kujdes me gjendjen tuaj emocionale para se të jepni komente. Nëse jeni në ankth apo të shqetësuar mund t'i shtrembëroni komentet që fillimisht mund të kenë qenë të dobishme. Dhënia e komenteve nuk është momenti që ju të shfryheni në kurriz të tjetrit. Para se të përgjigjeni fokusohuni tek personi të cilit po i jepni komente dhe tek nevojat e tij/saj, dhe jo tek vetja juaj. Po ashtu, mos i ngarkoni njerëzit më tepër se duhet vetëm sepse ju mund të keni shumë për të thënë apo dhënë.

Pranimi i Komenteve

Nuk ia vlen t'u kërkonti të tjerëve t'ju japin mendimet e tyre nëse nuk jeni vetë i gatshëm që të jeni të hapur dhe të merrni parasysh komente të cilat dallojnë nga perceptimet tuaja. Si pranues i komenteve:

- **Jini i qartë**

Bëjeni të qartë se çfarë lloj komentesh po kërkonti. Nëse është e nevojshme tregoni se çfarë lloj komentesh nuk dëshironi të pranoni. Komentet nga të tjerët shkojnë krejtësisht në përfitimin tuaj, dhe nëse nuk tregoni qartë se çfarë prisni atëherë vështirë se mund të merrni atë që doni.

- **Tregohuni i vëmendshëm**

Përqendrohuni krejtësisht në ato që po thuhet. Fokusohuni tek ato që personi do që ju të dini, dhe jo tek ato që nuk dëshiron t'i dëgjojë.

- **Jini i vetëdijshëm**

Vini re reagimet tuaja intelektuale dhe emocionale. Në mënyrë të veçantë, kujdesuni që të mos ketë ndonjë reagim, refuzim apo censurim nga ana juaj. Nëse këndvështrimi i tjetrit që po flet dallon nga i juaji, mos e largoni atë: mund të jetë e rëndësishme të sqarohen keqkuptimet e tjetrit. Disa njerëzve iu duket i dobishëm distancimi i vetvetes në këtë situatë dhe veprojnë sikur janë dëshmitarë të komenteve dhënë dikujt tjetër.

- **Jini i heshtur**

Frenohuni nga dhënia e përgjigjes. As mos filloni të formuloni përgjigje në kokën tuaj derisa ta keni dëgjuar me kujdes se çfarë po thuhet dhe të keni konsideruar se çka nënkuptohet. Mos u arsyetoni me korigjimin e gabimeve faktike për t'iu shmangur dëgjimit dhe koherencës me thelbin e asaj që po thuhet. Mos u hutoni nga nevoja për t'u shpjeguar: nëse ende e ndieni të nevojshme të shpjegoheni atëherë bëjeni pas përfundimit të kohës së komenteve, kur të siguroheni që i keni dëgjuar të gjitha ato që janë thënë.


- **Komentet me shkrim dhe komentet ballë-për-ballë**

Në parim, nuk ka dallim mes komenteve të dhëna me shkrim dhe komenteve të dhëna personalisht. Megjithatë, komentet me shkrim nuk para japin mundësi për zgjidhjen e keqkuptimeve, dhe ato duhet të jenë shumë të hollësishme në saktësimin e llojit të komenteve që lipsen dhe në formulimin e përgjigjeve. Me shkrim kërkohet më shumë vëmendje ndaj tonit dhe stilit të të shkruarit, meqenëse nuk ka mundësi për rregullimin e përgjigjes mbi bazën e reagimeve të menjëhershme nga tjetri.

Updated from Boud, D. (1991). Implementing Student Self Assessment. HERDSA Green Guide. No. 5. Second Edition. Sydney: HERDSA. Revised October 1994.




10.3 Vlerësimi për të nxënë (vlerësimi formativ) dhe vlerësimi i të nxënësve (vlerësimi sumativ)



Pse duhet ta ndryshojmë vlerësimin në klasë?

Ndryshimet në shoqëri bëjnë që edhe mësuesit të përballen me detyra të reja në klasat e tyre. Ata ballafaqohen me mënyra të ndryshme të mësimit dhe detyra të cilat duhet t'u përshtaten nxënësve dhe mënyrës se si mësojnë ata, edhe pse nuk janë të sigurtë se cilat ndryshime tjera i presin në të ardhmen. Gjatë dekadave të fundit, ndryshimet politike, sociale, ekonomike dhe ato mjedisore, e po ashtu edhe zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë kanë bërë që çdo aspekt i lidhur me shkollën të shqyrtohet dhe të rishikohet, duke përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve.


Deri vonë, vlerësimi në klasë është konsideruar si një mekanizëm për sigurimin e një indeksi të nxënësve, i cili ka marrë për bazë një model të parashikuar: mësuesit japin mësim, i testojnë njohuritë e nxënësve për përmbajtje të caktuara, gjykojnë për arritjet e tyre bazuar në ato 'testime' dhe më pas vazhdojnë me njësi tjera të reja. Kjo mënyrë e vlerësimit sot është vënë në pikëpyetje sepse pritjet shoqërore për arsimin sot kanë ndryshuar, shkencat kognitive kanë dhënë rezultate të reja për natyrën e të nxënësve, dhe roli tradicional i vlerësimit për motivimin e të nxënësve është sfiduar.



Korniza e Kurrikulës së Kosovës paraqet dokumentin kryesor për ciklin e ri të reformave në sistemin e arsimit në Kosovë. Ajo promovon (a) të nxënësve që reflekton përvojat paraprake të fëmijëve, interesat dhe mundësitë e tyre, (b) të nxënësve që është kuptimplotë dhe (c) përfshirje aktive të nxënësve në përzgjedhjen e përvojave të të nxënësve dhe vetëdijësimin e tyre për të vlerësuar dhe vetëvlerësuar.

Korniza e Kurrikulës së Kosovës promovon një qasje që bazohet në kompetenca, të cilat zhvillohen përmes të nxënësve që bazohet në punën praktike. Kjo qasje ka ndikim të rëndësishëm për organizimin e përvojave mësimore në shkollë, integrimin e çështjeve ndërkurrikulare, aftësitë për jetë; mësimin e integruar; mësimdhënien dhe të nxënësve ndërrpues; vlerësimin formativ dhe vlerësimin e progresit të nxënësve. Ajo promovon shfrytëzimin e Vlerësimit për Nxënës në mënyrë të vazhdueshme që ta përmirësojë shkallën e arritshmërisë në nivel klase, komune dhe në nivel shtetëror. Shumëllojshmëria e praktikave të vlerësimit në klasë do të mundësojë vlerësim të arritshmërisë së nxënësve, që është në pajtim me stilet e ndryshme të nxënësve¹⁰.

Ndryshimet në pritjet shoqërore, njohuritë për të nxënësve dhe për motivimin ndikojnë në punën e mësimdhënësve, në atë se si japin mësim, çka u mësojnë nxënësve dhe në veçanti, si i zbatojnë praktikave të vlerësimit në klasë.



“Mendimet rreth vlerësimeve kanë pësuar ndryshime në vitet e fundit. Në këndvështrimin e ri, vlerësimi dhe të nxënësve janë dy faqe të së njëjtës monedhë... Kur nxënësit angazhohen në vlerësim, të nxënësve e tyre rrjedh pikërisht nga ai vlerësim”.

National Research Council, National Science Education Standards.(Washington DC. National Academy Press, 1996)

10 Korniza e Kurrikulës e Kosovës

10.4 Përkufizime për vlerësimin dhe llojet e vlerësimit

Ç'është vlerësimi?

"... proces i mbledhjes së të dhënave në mënyrë që të merren vendime për një individ apo një grup të caktuar." (Salvia and Ysslydyke, 1998)

"... një varg metodash të përdorura për matjen e performancës dhe arritjes së nxënësve duke përfshirë, testimin, provimet, vlerësimet e punës praktike, vlerësimin me gojë, vlerësimet me bazë në klasë të udhëhequra nga mësuesit." (Gipps, 1994)

"... është proces i kërkimit dhe interpretimit të provave nga nxënësit dhe mësuesit e tyre për të vendosur se ku janë nxënësit, ku duhet të arrijnë ata dhe si të arrijnë atje më së miri." (Assessment reform group, 2002)

Kur dëgjojmë fjalën 'vlerësim', mendja na shkon tek provimet, testet, notat, stresi, sukcesi apo dështimi. Lehtë mund të konstatojmë se fjala është për një produkt që ndahet nga procesi i mësimit dhe i të nxënësve, për **Vlerësimin e të Nxënësve** (vlerësimi përmbljedhës), që ndodhë pas të nxënësve dhe na tregon se çfarë është arritur.

Nga ana tjetër, vlerësimi gjatë procesit të të nxënësve, (vlerësimi formativ) ka për qëllim që t'i informojë me kohë dhe me saktësi mësuesit dhe vetë nxënësit për punën e bërë drejtë arritjes së qëllimeve të mësimit. Në këtë rast mësuesit e përshtatin mësimit me nevojat e nxënësve, dhe nxënësit i përshtatin strategjitë e tyre të të nxënësve për qëllime të caktuara. Ky përdorim i vlerësimit, që njihet si **Vlerësimi për Nxënësit** (VpN) ndryshon nga Vlerësimi i të Nxënësve (ViN) sepse informacioni i mbledhur përdoret për qëllime të veçanta, për t'i ndihmuar nxënësit që ta përmirësojnë punën e tyre derisa ata janë duke marrë njohuri të reja dhe duke i zbatuar shkëlqësitë e tyre. Mësuesit të cilët e shohin vlerësimin si pjesë të pandashme të mësimit, i angazhojnë nxënësit e tyre si bashkëpunëtorë në procesin e të nxënësve.

Dy arsye kryesore të vlerësimit janë:

- (1) **Ndihmon të nxënësit**
- (2) **Raporton nëse ka ndodhur të nxënësit, dhe me çfarë efekti është realizuar të nxënësit**

Të gjitha vlerësimet, qoftë ato përmbljedhëse apo formative, i përmbajnë këta tre hapa:

- **Mbledhjen e të dhënave (informatave)**
- **Gjykimin në lidhje me të dhënat**
- **Shfrytëzimin e informatave për qëllime të caktuara**

10.5 Përzgjedhje e faqeve të dobishme në internet për mësimdhënësit

Fjalorë

<http://dictionary.cambridge.org>

Kërkoni online botime nga Kembrixhi të fjalorëve të Gjuhës Angleze, Anglishtja Amerikane, Foljet (Shprehjet) Frazologjike dhe Idiomatike. Shumë e dobishme.

<http://www.dictionary.com>

Fjalor i Gjuhës Angleze që gjendet online, përfshirë vegëza për fjalorë online të anglishtes dhe të gjuhëve të tjera, si dhe fjalorth të terminologjisë së zhargoneve të anglishtes. Nxënësit po ashtu mund të krijojnë karta me fjalë të ndryshme për pasurimin e fjalorit.

<http://www.edufind.com/english/grammar>

Referencë gjithëpërfshirëse që administrohet nga Shkolla e Anglishtes St. Johns' Wood në Londër.

Oxford Reference: English Dictionaries and Thesauruses

Variante online të fjalorëve të anglishtes dhe fjalorë sinonimesh e antonimesh botuar nga Oksfordi, me përkufizime (definicione) dhe etimologjinë e plotë të fjalëve dhe me referenca shumë të mira të kombinuara dhe vegëza të mëtutjeshme.

Wiktionary

Fjalor i hapur shumëgjuhësh me kontribut të përbashkët nga themeluesit e Wikipedias. Mundësia e kërkimit me terma dhe zgjedhja e gjuhës së dëshiruar.

Wordsmythe English Dictionary-Thesaurus

Fjalor online i anglishtes që ndryshon nga të tjerët, sepse kërkimi këtu prodhon fjalë dhe shprehje të ndërlidhura, përveç përkufizimeve (definicioneve).

World Wide Words: exploring the English language

Faqe magjepsëse dhe lehtë e lundrueshme që përmban prejardhjen dhe historikun e qindra fjalëve dhe shprehjeve në anglisht, përfshirë edhe terminologjinë moderne. E organizuar me indeksin e vet dhe sistemin e kërkimit. E rekomandueshme.

Mësimdhënësit e Anglishtes si Gjuhë e Huaj (EFL)

www.cactusteachers.com CactusTeachers

Shërbim që bën pranimin e kualifikimeve të njohura ndërkombëtarisht të Mësimdhënësve të Anglishtes si Gjuhë e Huaj (TEFL), siç janë Cambridge CELTA dhe Trinity CertTESOL. Faqja përmban informata të hollësishme mbi shkollën të ndryshme të mësimdhënies së Anglishtes si Gjuhë e Huaj në mbarë botën që i mësojnë kualifikimet e njohura, përfshirë formularin e aplikimit për secilën shkollë. Po ashtu, ka edhe këshilla mbi aplikimin për kurse të ndryshme, si dhe artikuj nga mësimdhënës të rinj të fushës, plus vegëza të dobishme për mësimdhënësit e rinj.

<http://ESLworldwide.com>

Këshilla dhe postime të vendeve të punës për mësimdhënësit e anglishtes jashtë vendit. Faqja përmban shpallje të vendeve të punës që ofrohen dhe vende të punës që kërkohen, si dhe krijon mundësinë që mësimdhënësit e anglishtes t'i shkëmbejnë idetë dhe përvojat e tyre.

<http://www.eslmag.com>

Revistë e përdymuajshme për profesionistë të fushës së Anglishtes si Gjuhë e Dytë (ESL).

<http://www.iatefl.org>

Shoqata Ndërkombëtare e Mësimdhënësve të Anglishtes si Gjuhë e Huaj.

<http://ietsj.org>

Ditar online mujor për mësimdhënësit e Testit të Anglishtes si Gjuhë e Huaj (TEFL), me artikuj, materiale mësimore dhe vegëza. Një sektor i faqes – <http://a4esl.org> – përmban aktivitete për ata që janë duke mësuar anglishten.

<http://www.tea-austria.org>

TEA është një organizatë profesionale për mësimdhënësit e Gjuhës Angleze si Gjuhë e Huaj (TEFL) që punojnë në Austri. Përveç informacioneve mbi organizatën dhe aktivitetet e tyre, faqja përmban edhe vegëza të dobishme për faqe të ndërlidhura.

<http://www.tefl.net>

Qendër burimesh të shumta për mësimdhënësit e Gjuhës Angleze, përfshirë Qendrën e Punësimit, forum për diskutime dhe një shitore elektronike ku mund të blihen materiale mësimore.

<http://www.tefl.com>

Burim për mësimdhënësit e Gjuhës Angleze si Gjuhë e Huaj (TEFL) ku përfshihet një listë e përditësuar e vendeve të punës të kategorizuara sipas shteteve dhe vegëza për burime të mëtejshme në Internet.

http://www.zait.uni-bremen.de/wwwgast/tesl_ej

TESL-EJ është një ditar elektronik ku publikohen artikuj mbi hulumtimet dhe praktikat e mësimdhënies së anglishtes si gjuhë e huaj ose si gjuhë e dytë.

<http://www.tesol.org>

Faqja e Internetit për Mësimdhënësit e Anglishtes që u mësojnë gjuhën folësve të gjuhëve të tjera.

Të nxënit

<http://www.eslcafe.com>

“Ku Mësimdhënia e Anglishtes është Zbavitje!” Një faqe Interneti e ngrohtë për nxënësit dhe mësimdhënësit e Anglishtes si Gjuhë e Dytë me burime gjuhësore dhe dhoma bisedimi online.

<http://www.english-at-home.com>

Një përmbledhje e madhe e burimeve për njerëzit që e mësojnë anglishten në shtëpi, përfshirë gramatikën dhe fjalorin, “Real Life English”, “Radio Room” ku mund të dëgjohen stacione radiofonike në anglisht online, forume dhe gazetë online.

<http://www.englishclub.net>

Burime të shumta, përfshirë materiale referencash, mjete ndihmëse dhe kuize për mësimdhënësit dhe nxënësit të anglishtes.

<http://www.study.com>

Orë mësimi të anglishtes online për nxënës fillestarë dhe të avancuar të anglishtes.

<http://www.freeenglish.com>

Lojëra për nxënësit e anglishtes (të zhvilluara në Flash) dhe programe (softuer) që mund të shkarkohen për përdoruesit që regjistrohen gratis në faqe.

<http://www.manythings.org>

Aktivitete interaktive që përdorin programet Flash, Javascript, dhe Java për nxënësit e anglishtes, përfshirë kuize, gjenerues të fjalive, dhe Hangman. Fokusi është mbi anglishten amerikane.

<http://www.britishcouncil.org/learnenglish>

Faqja e Internetit e British Council për nxënësit e anglishtes. Faqja ka materiale të shumta leximi, informacion mbi kurset dhe vegëza për faqe të tjera të Internetit. Nxënësit mund të hyjnë në faqe duke përdorur gjuhën e tyre të parë dhe të identifikojnë zonën e të nxënësve sipas nivelit të njohurive të secilit. Gjuhët aktualisht të disponueshme janë arabisht, kinezisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, portugalisht, rusisht dhe spanjisht.

<http://www.learningchocolate.com>

Shumë burime të lezetshme interaktive për të pasuruar fjalorin duke përdorur fotografi dhe sekuenca audio në formatin Adobe Flash të kategorizuara (p.sh. kafshët, trupi, malet etj.) Ka gjithashtu vegëza të mëtejme.

<http://www.bbc.co.uk/worldservice/learningenglish>

Mësoni të përmirësoni anglishten tuaj me këtë faqe interaktive multimediale të administruar nga BBC, e cila përdor sekuenca origjinale në video dhe audio. Ka mësim për fillestarë në një përzgjedhje gjuhësh të pazakonta.

<http://www.esl-lab.com>

Shumë kuize dëgjimore në anglisht që përdorin materiale audio dhe video. Secili kuiz ka aktivitete para-dëgjimore, dëgjimi, dhe pas-dëgjimore, dhe transkriptet e secilës pjesë mund të gjenden me anë të fjalëve 'shënjestër'. Po ashtu ka një tabelë shpalljesh (Bulletin Board) dhe qendër për të biseduar (Chat Center).

<http://foreignborn.com>

Informacion i hollësishëm praktik për të huajt që vizitojnë SHBA-të, që mund t'u shërbejë nxënësve të Anglishtes si Gjuhë e Huaj që dëshirojnë të studiojnë në SHBA.

Mediat**www.cnn.com**

Shërbimi i famshëm amerikan i lajmeve online, përfshirë lajme audio drejtpërdrejt.

www.bbc.co.uk

Faqja mediale më e madhe në Angli, mbase edhe në botë, që përmban lajme, shpallje, programe, materiale arsimore-edukative, dhe shumë më tepër.

- **BBC English Radio** Departamenti i Mësimdhënies së Gjuhës Angleze i Shërbimit Botëror të BBC-së. Përmban programin e radios dhe burime të mësimdhënies.
- **BBC World Service** Faqe e pasur që përfshin shërbim radiofonik botëror dhe materiale edukative për Gjuhën Angleze mbi bazën e transmetimeve të zgjedhura.

<http://www.mirror.co.uk>

Edicioni online i gazetës së famshme angleze me lajme nga bota e artit dhe njerëzve të famshëm.

<http://www.thebigproject.co.uk//news/>

Një përmbledhje vegëzash të gazetave nga bota anglishtfolëse, si dhe jo-anglishtfolëse që botohen në anglisht.

Burimet

Burime të përgjithshme për këdo që është i interesuar në anglishten në përgjithësi, apo në Testin e Anglishtes si Gjuhë e Huaj (TEFL) në veçanti.

<http://towerofenglish.com>

Shumë vegëza drejt faqeve të Anglishtes si Gjuhë e Dytë të kategorizuara në 'kate' të ndryshme të një Kulle.

<http://www.wisc-online.com>

Kjo faqe ka Objekte të të Nxënës të Ripërdorshme (RLO) ka 18 sosh, në kohën e shkrimit, në seksionin ABE/ESL, me tituj si Të Shkruajmë Ese dhe Të Lëmë Mesazh Telefonik. RLO-të dhe krejt faqja mund të implementohen në formatin Flash.

Burime për mësimdhënien e anglishtes.

www.1-language.com

Një burim gratis për mësimdhënësit dhe nxënësit e Anglishtes si Gjuhë e Huaj, përfshirë kuize gramatikore, një 'qendër' pune për mësimdhënësit, fletë pune, një bibliotekë me tekste të ndryshme, lojëra, forume, teste online, etj. Disa pjesë të faqes kërkojnë formate si Macromedia Flash plugin.

<http://FreeVocabulary.com>

Listë në rend alfabetik të 5000 fjalëve në anglisht me përkufizime të shkurtra.

<http://www.baysight.com/aardwark>

Vegëza, burime dhe kontakte për nxënësit dhe mësimdhënësit e Anglishtes si Gjuhë e Huaj. Ka ushtrime interaktive për gramatikë, fjalor, dhe idioma të kombinuara në të gjitha nivelet, si dhe një Kuiz mbi Flamujt & Vendet.

<http://education.guardian.co.uk/tefl/>

'Mysafir' i faqes zyrtare të gazetës The Guardian, kjo faqe ka shumë burime për nxënësit dhe mësimdhënësit e anglishtes, përfshirë një regjistër vegëzash të veçanta, plane mësimore të bazuara në ngjarjet e lajmeve të fundit, dhe një forum për mësuesit.

<http://grammar.ccc.comnet.edu/grammar/>

Shumë referenca gramatikore në anglisht dhe ushtrime interaktive (të shkruara në Javascript dhe CGI). Një burim i shkëlqyer për mësimdhënësit dhe nxënësit e anglishtes.

www.lingolex.com/jstefl.htm

Materiale mësimore gratis për mësimin e Anglishtes si Gjuhë e Huaj dhe softuerin CALL.

11. Qasja komunikative në të nxëniet e gjuhës angleze

Rëndësia që i kushtohet mësimin të gjuhëve të huaja, e veçanërisht mësimin të gjuhës angleze në kontekstin e Kosovës është rezultat i natyrshëm jo vetëm i traditës, por edhe si pasojë e realitetit të ri të krijuar në Kosovë. Megjithatë, krijimit të realitetit të ri i kanë paraprirë një varg procesesh të vazhdueshme të integritit në nivelin evropian dhe botëror, të cilat padyshim nuk kanë mundur të arrihen pa komunikim, ndërveprim dhe të kuptuar të ndërsjellë në mes të njerëzve të përkatësive të ndryshme gjuhësore, etnike dhe kulturore. Rrjedhimisht, interesimi për mësimin e gjuhëve të huaja është vazhdimisht në rritje, gjë që është në përputhje të plotë me trendet globale kur merret parasysh globalizimi dhe nevoja për komunikim ndërmjet kulturave. Interesimi për gjuhën angleze bëhet legjitim, kur merret parasysh statusi dhe roli që e ka gjuha angleze sot duke qenë *'lingua franca'* e botës së civilizuar.

Në thelb të të gjitha përpjekjeve është orientimi shoqëror për mësimin e gjuhëve. Bazuar në faktin se në jetën e përditshme çdo individ duhet të kryej një varg detyrash çdo ditë, të gjitha dokumentet promovojnë mësimin aktiv dhe qasjen e orientuar drejt veprimit, në thelb të të cilave është qëndrimi se përdoruesit e gjuhës duhet të shikohen si faktorë në shoqëri. Për të përmbushur detyrat që i janë dhënë një individ, ai/ajo duhet të jetë i pajisur me një varg kompetencash që përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë që mundësojnë komunikimin efektiv ndërmjet njerëzve; me fjalë të tjera, ai/ajo duhet të jetë i aftë për të qenë komunikues efektiv.

Pyetjet që ngrihen në lidhje me kompetencat e komunikimit janë: 'Çka është komunikimi efektiv?' 'Çka përfshin ai?' 'Çka duhet të di njeriu për të komunikuar me të tjerët?'. Përgjigjet duket se janë të thjeshta: komunikim i suksesshëm do të thotë *'të dish se si, kur, dhe pse duhet t'i thuash diçka dikujt'*. Të gjitha njohuritë gjuhësore dhe shoqërore për ndërveprim efektiv janë të përfshira në këto dhjetë fjalë. Në të kaluarën një theks i veçantë është vënë në pyetjen **si** (gramatikë) dhe **çka** (fjalorth)¹¹. Nëse tërhiqet një paralele në mes të gjuhës dhe një ndërtese, gramatika mund të konsiderohet si plani i arkitektit ndërsa fjalët si blloqet ndërtimore. Prandaj, pa planin e arkitektit nuk mund të ndërtohet ndërtesa edhe nëse njeriu i ka një milionë blloqe¹². Është e qartë se qasjet që përdoren sot në mësimin e gjuhëve të huaja kanë për qëllim të mundësojnë një ndërveprim të vërtetë me të tjerët. Prandaj, komunikimi përfshinë pyetjen **pse, kujt** dhe **kur**, pasi që ato ofrojnë mundësinë për të komunikuar në mënyrë të kuptueshme dhe të duhur me përdoruesit e gjuhëve të tjera pavarësisht faktit se a jetojnë ata në të njëjtën lagje, në distancë apo edhe në ndonjë kontinent tjetër.

Në mësimin e gjuhëve, vëmendja e nxënësve mund të fokusohet në çështje të caktuara ose në gjuhën në tërësi. Në rastet kur duam të fokusojmë vëmendjen e nxënësit të gjuhës së huaj në pjesë të caktuara, ato pjesë mund të jenë struktura gramatikore (koha), funksion gjuhësor (shprehje e falënderimit), fushë që ka të bëjë me fjalorin (ushqim dhe pije), ose tipare fonologjike (theksi apo një tingull i caktuar). Në anën tjetër, kur vëmendja fokusohet në gjuhën në tërësi,

11 Këshilli Amerikan për Mësimin e Gjuhëve të Huaja. Standardet për Mësimin e Gjuhëve të Huaja, Përgatitja për Shekullin 21. Standardet Kombëtare në Shkollimin për Gjuhë të Huaja. www.actfl.org/files/public/StandardsforFLLexecsumm_rev.pdf

12 Sesnan. B. 1997. How to Teach English. OUP.

nxënësit, përmes një numri të madh aktiviteteve, e përdorin gjuhën për qëllime praktike apo reale, me fjalë të tjera, ata veprojnë si përdorues të vërtetë të gjuhës.

Përparësia e qasjes gjithëpërfshirëse në mësimin e gjuhëve qëndron në faktin se ajo u mundëson atyre që e mësojnë atë gjuhë ta konsiderojnë atë si mjet të fuqishëm për komunikim dhe ndërveprim e jo si një mësim steril, jorealit dhe i nxjerr jashtë kontekstit; kështu pra edhe artificial dhe jo autentik, siç është rasti kur nxënësit i ekspozohen gjuhës së segmentuar, kur nuk u mësohet gjuha por meta-gjuha. Këtu do të fokusohemi në përdorimin e gjuhës krahas mësimin të saj, që nënkupton se gjuha konsiderohet si mjet dhe qëllim, e jo si qëllim në vete.

Sot është pranuar botërisht se ekzistenca e shumë informatave është bërë parim udhëzues në arsim; prandaj edhe promovohet mësimdhënia e ndryshme. Kjo aplikohet edhe për të nxënësit. Në anën tjetër, fjala *shkrim-lexim* po ashtu është ri-vlerësuar në aspektin semantik. Ajo më nuk aplikohet në mënyrë ekskluzive vetëm për aftësinë për të lexuar dhe shkruar, por ajo përfshinë edhe lloje të tjera të aftësive: aftësi për kompjuterë, aftësi për muzikë, aftësi për arte vizuale dhe të ngjashme. Qasjet komunikative i marrin parasysh të gjitha këto dhe i integrojnë procedurat, strategjitë dhe teknikat që shfrytëzojnë potencialin e materialeve jogjuhësore dhe jashtë-gjuhësore duke i përdorur ato si materiale për mësimdhënie për të mundësuar një komunikim të vërtetë. Prandaj, mësimdhënësit e gjuhës duhet të inkurajojnë nxënësit, veçanërisht në fazat e hershme të mësimin, që të përdorin ato lloje të aftësive në të cilat kanë besim më shumë, ose të cilat i konsiderojnë si më të duhurat në një moment të caktuar. Kjo veçanërisht vlen për nxënësit e rinj, por nuk përjashtohet as për tinxherët dhe nxënësit e rritur. Nxënësit mund të dallojnë për nga moshën, megjithatë, në ambientin e klasës ata janë të prirë të sillen pak a shumë në mënyrë të njëjtë.

Meqë komunikimi kryesisht nënkupton dërgimin dhe pranimin e porosive, nxënësit duhet të zhvillojnë katër aftësitë gjuhësore të cilat përbëjnë thelbin e komunikimit. *Zhvillimi i aftësive perceptuese*, siç është *dëgjimi* dhe *leximi*, do t'u mundësojë nxënësve që të pranojnë porosi dhe varësisht prej detyrave që ata duhet të përmbushin, të zgjedhin informacionin e rëndësishëm. Megjithatë, meqë aftësitë gjuhësore nuk janë të izoluar por zakonisht janë të integruara për qëllime të komunikimit, pasi të jetë pranuar porosia dhe pasi të jetë identifikuar dhe përzgjedhur informata e rëndësishme për përmbushjen e detyrës, nxënësit duhet të jenë në gjendje që të marrin vendime dhe të përgjigjen si duhet në një situatë konkrete ndaj një kërkesë konkrete. Në një situatë që ka të bëjë me gjuhën, përgjigja e tyre është funksion edukativ, i cili kryhet nga njëra prej *aftësive produktive*, nga të *folurit* ose nga të *shkruarit*.

Duke marrë parasysh informatat e shumta dhe rrjedhimisht, llojet e ndryshme të nxënësve, **qasjet bashkëkohore** promovojnë të mësuarit aktiv. Qasjet komunikative, të mësuarit e bazuar në detyra, dhe të mësuarit e bazuar në projekte ofrojnë një varg mundësish për të zgjuar kureshtjen dhe motivimin e nxënësve, për të angazhuar nxënësit në aktivitetet në klasë dhe për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të aftësive, shkathtësive, mundësive dhe qëndrimeve të tyre. Në klasë, nxënësit mund të angazhohen në përmbushjen e një vargu detyrash. Pyetja që ngrihet në këtë rast është: "Çka konsiderohet si detyrë?"

Detyrë është çdo aktivitet i cili ka për qëllim që të arrijë një qëllim konkret duke aplikuar një procedurë ose një varg procedurash ose një varg strategjish. Mbështetësit e të mësuarit të bazuar në detyra e pranojnë botërisht se detyrë në klasë mund të jetë çdo gjë, p.sh., gjetja e një lokacioni, leximi i hartës, gjetja e një zgjidhjeje të një gjëgjëzë, gjetja e një adrese përmes leximit të hartës, matja e dimensioneve të një objekti, ose ndërtimi i një aeroplani lodër, ose parashikimi

i fatit duke ndjekur udhëzimet e mësimdhënësit, hartimi i planit të objektit të shkollës, porositja e një ushqimi duke lexuar menynë, bërja e një telefonate dhe të ngjashme. Në rastin tonë, kjo do të thotë mësimi i gjuhës angleze, me përjashtim të qëllimit të përbashkët, është po aq e rëndësishme të vihen në përdorim njohuritë dhe aftësitë e nxënësve dhe t'u mundësohet atyre që të komunikojnë, ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me kolegët e tyre për përmbushjen e detyrës, duke u fokusuar në kuptimin edhe formën¹³ pasi që gramatika është njohuri që gjendet në kokën e individit dhe jo në rregullat e ndonjë libri¹⁴. Duke përmbushur detyrën, duke ndërmarrë projekte, duke punuar në grupe, duke bashkëvepruar, duke ndarë dhe duke u përkujdesur, duke shkëmbyer informata, duke punuar punën dhe duke qenë të përgjegjshëm, nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe ndërpersonale dhe përgatiten më mirë për punën ekipore që i pret ata në situata të jetës reale.

Siç u theksua në paragrafin e mëhershëm, ekziston një larmi e gjerë detyrash që mund të përdoren si aktivitete gjuhësore në klasë: disa prej të cilave janë lojërat, iluzionet optike, fjalëkryqet dhe gjëgjëzat, por edhe aktivitetet praktike të cilat përveç angazhimit intelektual të nxënësve kërkojnë edhe angazhim mendor. Të gjitha këto kanë të përbashkëta përpjekjet për largimin e kërcënimit dhe frikës nga bërja e gabimeve dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për nxënësit që të lehtësohet procesi i mësimdhënies dhe nxënies.

Përparësitë e pranuar botërisht të qasjes përmes komunikimit dhe mësimi të bazuar në detyra janë si vijon:

- ***Në procesin e mësimi, nxënësit nuk e studiojnë gjuhën, por ata marrin pjesë në aktivitetet të cilat kanë vlerë të shkollimit praktik;***
- ***Temat dhe fushat e mësimi janë në sferën e interesit të nxënësve, gjë që duhet të rris nivelin e motivimit dhe angazhimit;***
- ***Nxënësit i ekspozohen gjuhës angleze në formën e saj natyrale, autentike dhe jo-artificiale. Kjo gjuhë ka gjasë të jetë kuptimplotë, e me këtë është e kuptueshme se edhe aktivitetet janë kuptimplotë.***
- ***I tërë aktiviteti zhvillohet në gjuhën angleze, prandaj nxënësit e konsiderojnë gjuhën angleze si mjet të komunikimit e jo si një produkt final;***
- ***Gjuha nuk mësohet përmes një grumbulli strukturash gramatikore. Fitimi i njohurive dhe perceptimi i realitetit bëhen në gjuhën angleze, kështu që gjuha që dëshirohet të mësohet përdoret edhe si mjet edhe si qëllim;***
- ***Mësimi bëhet në grupe me nxënës që kanë njohuri të ndryshme. Grupet me aftësi të ndryshme janë të pashmangshme në të gjitha fazat e mësimi të gjuhës nëpër shkolla. Megjithatë, kjo kthehet në përparësi në qasjet komunikuese dhe në mësimin e bazuar në detyra. Nxënësit me sfond të dobët të njohurive përfitojnë nga puna grupore pasi që duke bashkëpunuar në një detyrë ata mësojnë jo vetëm nga mësimdhënësi dhe materialet e tyre, por edhe nga kolegët e tyre.***
- ***Në procesin e mësimi, vëmendja fokusohet në nxënësit si individë, prandaj nxënësit inkurajohen që të studiojnë dhe mësojnë sipas dinamikës së tyre duke përdorur stilin e tyre të preferuar të nxënies.***

13 Skehan, P. 1996. Second Language Acquisition and research and Task-Based Learning in Willis, J. and D. Willis. (eds). Challenge and Change in Language Teaching. Oxford: Heinemann; Nunan, D. 1989. Designing Tasks for the Communicative Language Classroom. New York. Cambridge University Press.

14 Cook, V. 1991. Second Language Learning and Language Teaching. Edward Arnold. London.

Qasjet përmes komunikimit dhe mësimin të bazuar në detyra kërkojnë që të fillohet nga roli tradicional i mësimdhënësit, si dhe i nxënësit¹⁵. Në mësimin e gjuhës përmes komunikimit roli kyç i mësimdhënësit është që të lehtësojë mësimin, që kryesisht nënkupton se:

- *Ai/ajo i koordinon aktivitetet në klasë. Rrjedhimisht, roli i mësimdhënësit është më pak dominues, dhe e obligon atë që të vë theksin në kontributin e nxënësve përmes mësimin të pavarur me burimet e dhëna;*
- *Si drejtues i klasës, mësimdhënësi është përgjegjës për grupimin e aktiviteteve në 'mësime';*
- *Në disa aktivitete mësimdhënësi mund të luaj rolin e instruktorit të gjuhës duke paraqitur gjuhën e re, duke pasur kontroll të drejtpërdrejtë mbi performancën e nxënësve, vlerësimin dhe përmirësimin e saj;*
- *Në aktivitetet e tjera, ai/ajo mund të intervenojë, por nuk do të lejojë që mësimi të zhvillohet përmes aktiviteteve të pavarura;*
- *Në aktivitetet gjuhësore, klasa ndahet në çifte dhe grupe të cilat ndërveprojnë në mënyrë të pavarur nga mësimdhënësi. Në aktivitetet e pavarura ai/ajo mund të veprojë si person konsulent, këshilltar ose monitorues, për të zbuluar pikat e dobëta dhe të forta të nxënësve, të cilat ai/ajo do t'i përdor si bazë për planifikimin e aktiviteteve të planifikimit;*
- *Herë pas here, mësimdhënësi mund të marrë pjesë në aktivitetet si 'komunikues' që stimulon dhe që prezanton gjuhën e re, por duke ua lënë iniciativën vet nxënësve. Me marrjen e rolit të 'komunikuesit' mësimdhënësi e vë veten në baza të barabarta me nxënësit. Kjo ndihmon në uljen e tensionit dhe tejkalimin e pengesave ndërmjet tyre, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm për të mësuar. Si pasojë, raportet në mes të nxënësve dhe në mes të mësuesit dhe nxënësve janë më të relaksuara dhe më bashkëpunuese, gjë që mundëson ndërveprimin;*
- *Nxënësit nuk korrigjohen vazhdimisht. Gabimet trajtohen me më shumë tolerancë, si fenomen normal në zhvillimin e aftësive komunikuese, ku fokusi vihet në të folurit e rrjedhshëm e jo në saktësi.*

Çfarë ndryshimesh janë vërejtur në rolin e nxënësve në qasjet komunikuese dhe në mësimin e bazuar në detyra? Pasi që theksi vihet në procesin e komunikimit e jo në zotërimin e formave gjuhësore, nxënësi e merr rolin e negociatorit të përbashkët¹⁶. Në procesin e të nxënësve, ai/ajo negocion në mes të:

- **(Vet) Nxënësit, procesit dhe objektit të të nxënësve.** Ky lloj i negociimit është me rëndësi në procesin e mësimin, pasi që ai u mundëson nxënësve që t'i zhvillojnë aftësitë e tyre kritike, të marrin vendime, të marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre dhe të mësojnë në mënyrë të pavarur.

Mësimdhënësit duhet:

- t'i inkurajojnë nxënësit që t'i marrin përgjegjësitë për të mësuarit e tyre, duke u ofruar atyre mundësi për punë individuale dhe të pavarur.
- T'u mundësojnë nxënësve që të mësojnë sipas dinamikës që dëshirojnë në mënyrë që t'i arrijnë rezultatet e caktuara të mësimin.

15 Littlewood, W. 1981. Communicative Language Teaching. Cambridge University Press.

16 Bren, M. & C. N. Candlin. 1980. The Essentials of the Communicative Curriculum in Language Teaching. In Applied Linguistics 1(2): 89 – 112.

Përfitimet e nxënësve nga ky lloj i negociatave janë të shumëfishta: ata fitojnë vetëbesim, janë të gatshëm të ndërmarrin iniciativa, të rrezikojnë dhe të marrin vendime të bazuara në informata të mjaftueshme dhe të besueshme.

- **Nxënësit dhe grupit në kuadër të aktiviteteve që ndërmerr klasa.** Përmes këtij lloji të negociimit nxënësit fitojnë vetëbesim në ndërveprim, në ndarjen dhe shkëmbimin e informatave.

Në aktivitetet dhe procedurat grupore, ata:

- fitojnë vetërespekt,
 - mësojnë që të tregojnë respekt për kolegët e tyre,
 - bashkëpunojnë me ta, dhe
 - i përshtatin pikëpamjet e veta në disa situata të caktuara në mënyrë që grupi të marrë vendime të përbashkëta, e të ngjashme.
- **Nxënësit dhe klasës në kuadër të aktiviteteve që ndërmerr grupi.** Përmes këtij lloji negociimi nxënësit mësojnë që t'i ndajnë përgjegjësitë me të tjerët dhe të kontribuojnë si individë dhe si anëtarë të ekipit në përmbushjen e detyrës. Kjo e rrit vetëdijesimin në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë si individë në klasë, në shkollë, në komunitet dhe në tërë botën.




11.1 Portofolioja e mësimdhënësit

Portfolio është një mjet ndihmës esencial për zhvillimin profesional. Portfolio është një dokument ku mund të regjistroni arritjet dhe ju mundëson që të reflektoni mbi mësimdhënien dhe për të ardhmen. Portofolio e juaj është një dokument i gjallë i cili ndryshon me kalimin e kohës duke ju mundësuar vlerësimin e mësimdhënies tuaj, reflekton dhe vepron sipas rezultateve, dhe mundëson zhvillimin e qasjeve të reja. Portfolio zakonisht përmban nga gjashtë deri në dymbëdhjetë faqe dhe zakonisht shoqërohet me shtesa të dokumenteve suplementare. Faqet ofrojnë një përmbledhje të arritjeve tuaja në karrierë me shembuj, komente dhe plane afatshkurtra dhe afatgjata. Në portfolio duhet të theksohen, ndryshimet dhe zhvillimi i mësimdhënies tuaj gjatë kalimit të kohës.

Portfolio zakonisht zhvillohet në faza, prej mbledhjes së informatave deri tek eksplorimi i metodave të reja të mësimdhënies duke reflektuar dhe ndërmarrë veprime të planifikuara.

Ju mund ta përdorni modelin e mëposhtëm për t'ju ndihmuar në reflektim për mësimdhënien tuaj.



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË SHFRYTËZOHET PORTFOLIO

- Paraqet një portret të saktë dhe të përmbledhur të aktiviteteve të organizuara për të realizuar rezultatet mësimore dhe për të përmirësuar të nxënësit;
- Përmirëson mësimdhënien duke integruar vlerësimin për të nxënë;
- Mundëson (vetë)përcjelljen e punës së mësimdhënësit dhe lehtëson procesin e certifikimit
- Ndihmon në vetëvlerësimin e mësimdhënësit.

PËRGATITJA E PORTFOLIOS TUAJ

Komponentet e portfolios

Në thelb nuk ekziston një platformë ku përshkruhet përmbajtja e një portfolioje. Secila portfolio është unike, por zakonisht përmban shumicën e informatave të mëposhtme. Portfolio duhet të jetë e qartë dhe koncize.

Do të ishte e përshtatshme që informatat në portfolion tuaj lidhur me aktivitetet e realizuara të ndahen në dy pjesë: pjesa e parë ku përfshihen përshkrimi, reflektimi dhe ndikimi i aktivitetit

dhe pjesa e dytë në të cilën vendosen dokumente shtesë (plane mësimore, procesverbale të reflektimit, foto, video etj) si provë e përmbajtjes së mësipërme.

Programi i ri i USAID-it Basic Education Program (BEP) është mjaft i dobishëm meqenëse përkrah përpjekjet për reforma arsimore të Qeverisë së Kosovës. Një ndër kushtet e këtij programi për certifikim si fasilitator është edhe portfolio e fasilitatorit. Për ta bërë më të lehtë caktimin e përmbajtjes së portfolios , me poshtë në mënyrë të përgjithshme janë të renditura disa nga komponentet që duhet të përmbajë një portfolio e mësimdhënësit.

I. Faqja e parë (FAQJA KRYESORE)

1. Të dhënat personale:

- Emri dhe mbiemri të shoqëruar me foto
- Vendbanimi
- Lëmia - profesioni
- Institucioni
- Të dhënat tjera personale shtesë sipas dëshirës

2. Kontakt forma:

- Mundësia për të bërë pyetje dhe komente

II. Faqja e dytë (SHKOLLIMI - PËRGATITJA AKADEMIKE)

1. Shkollimi fillor

- Vendi, koha dhe institucioni

2. Shkollimi i mesëm

- Vendi, koha , institucioni dhe drejtimi

3. Shkollimi i lartë dhe pasuniversitar

- Vendi, koha, institucioni (universiteti), fakulteti, drejtimi dhe titulli i fituar

III. Faqja e tretë (PËRGATITJA PROFESIONALE – PËRVOJA E PUNËS)

1. Pozita e punës

- Vendi, institucioni, koha
- Përshkrim i shkurtë i përgjegjësive të kësaj pozite

IV. Faqja e katërt (PJESËMARRJA NË PUNËTORI – TRAJNIME)

1. Lloji i punëtorisë - trajnimit

- Tema e punëtorisë, koha, vendi dhe organizatori

- Përshkrim i shkurtër i objektivave të punëtorisë
- Titulli i fituar dhe përgjegjësitë

V. Faqja e pestë (PËRVOJAT SI FASILITATOR)

1. Punëtoritë e fasilituara

- Lloji i punëtorisë, vendi, koha dhe institucioni organizator
- Përmbajtja e punëtorisë - agjenda
- Numri i pjesëmarrësve
- Përshkrimi i objektivave të punëtorisë
- Reflektim nga punëtorja (të shoqëruara me foto, video dhe komente)
- Informata tjera shtesë

VI. Faqja e gjashtë (PËRVOJAT SI MËSIMDHËNËS)

1. Plani i punës (aktivitetit)

- Lënda
- Emri i aktivitetit
- Objektivat e aktivitetit
- Mjetet e nevojshme
- Vendi i mbajtjes së aktivitetit
- Koha
- Mosha - klasa dhe numri i pjesëmarrësve

2. Aktiviteti

- Koha e mbajtjes
- Emri i shkollës, klasa dhe numri i nxënësve
- Vendi i realizimit të aktivitetit (klasë, laborator, kabinet, teren etj)
- Reflektim mbi ecurinë e realizimit të shoqëruar me foto, video dhe komente

VII. Faqja e shtatë (INFORMATA TJERA)

1. Foto galeri

2. Dokumente

3. Video

4. Etj.

KRIJIMI I PORTFOLIOS ELEKTRONIKE

Ju mund të hapni edhe Portfolio elektronike duke shfrytëzuar ueb faqen: www.weebly.com.

12. Lista e referencave

Ahmad, at all. 1985. *Computers, language learning and language teaching*, Cambridge: Cambridge University Press. Cited in Lee, Op. Cit.

Bax S. (2003) "CALL - past, present and future", *System* 31, 1: 13-28. In Davies, G. Op. Cit.

Boud, D. (1991). *Implementing Student Self Assessment*. HERDSA Green Guide. No. 5. Second Edition. Sydney: HERDSA. Revised October 1994.

Bren, M. & C. N. Candlin. 1980. *The Essentials of the Communicative Curriculum in Language Teaching*. In *Applied Linguistics* 1(2): 89 – 112.

Cook, V. 1991. *Second Language Learning and Language Teaching*. Edward Arnold. London.

Davis. G. *Computer Assisted Language Learning: Where are we now and where are we going?* CALL Conference, University of Ulster at Coleraine, 14-15 June 2005, Conference on E-Learning and Japanese Language Education: Pedagogy and Practice, Oxford Brookes University, 31 March to 1 April 2007. www.camsoftpartners.co.uk/docs/UCALL_keynote.htm

Dhaif, H. A.(1989). Can computers teach languages? *English teaching forum*.27(3),pp.17-19. In Gündüz, N. Op. Cit.

Gündüz, N. *Computer Assisted Language Learning (CALL)*
www.jlls.org/Issues/Volume1/No2/nazligunduz.pdf

Ittelson, J C. (2000). Computers. *Microsoft encarta encyclopedia 2000*. 1993-1999 Microsoft Corporation. Cited in Gündüz, N. Op. Cit. www.jlls.org/Issues/Volume1/No2/nazligunduz.pdf

Kenning, M., J. & Kenning M. M. (1983). *Introduction to computer assisted language teaching*. Oxford: OUP. Cited in Gündüz, N.; Davies, G.; and Lee, K. Op. Cit.

Këshilli i Evropës. 2001. *Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët: Nxënia, Mësimdhënia dhe Vlerësimi*, Cambridge University Press.

Këshilli Amerikan për Mësimin e Gjuhëve të Huaja. *Standardet për Mësimin e Gjuhëve të Huaja, Përgatitja për Shekullin 21*. Standardet Kombëtare në Shkollimin për Gjuhë të Huaja.
www.actfl.org/files/public/StandardsforFLLexecsumm_rev.pdf

Këshilli i Evropës. 2001. *Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët: Nxënia, Mësimdhënia dhe Vlerësimi*, Cambridge University Press.

Lee, K. *English Teachers' Barriers to the Use of Computer-assisted Language Learning*. In *The Internet TESL Journal*, Vol. VI, No. 12, December 2000. <http://iteslj.org/>

Littlewood, W. 1981. *Communicative Language Teaching*. Cambridge University Press.

McLuhan, Marshall. *Using ICT in ELT, The Medium is the Message*.

Sesnan. B. 1997. *How to Teach English*. OUP.

Skehan. P. 1996. *Second Language Acquisition and research and Task-Based Learning* in Willis. J. and D. Willis. (eds). *Challenge and Change in Language Teaching*. Oxford: Heinemann; Nunan. D. 1989. *Designing Tasks for the Communicative Language Classroom*. New York. Cambridge University Press.

Stevens V. (ed.) (1989) "A direction for CALL: from behavioristic to humanistic courseware". In Pennington M. (ed.), *Teaching languages with computers: the state of the art*, La Jolla, CA: Athelstan: 31-43. Cited in Warschauer. Op. Cit.

Underwood J. (1984) *Linguistics, computers and the language teacher: a communicative approach*, Rowley, MA: Newbury House. Cited in Warschauer Op. Cit.

Warschauer, M. (1996) "Computer Assisted Language Learning: an Introduction". In Fotos S. (ed.) *Multimedia language teaching*, Tokyo: Logos International: 3-20.
www.ict4lt.org/en/warschauer.htm

Wright, A. , D. Batteridge & M. Buckby. *Games for Language Learning*. Cambridge University Press.

eRESOURCES ON VARIOUS TOPICS AND ENGLISH SPEAKING CULTURES - CAN BE USED IN MAKING LEARNING MORE ATTRACTIVE

Workshop activity: Economy

General

- The Word "Dollar" and the Dollar Sign \$
<http://projects.exeter.ac.uk/RDavies/arian/dollar.html>
- Currency Converter
<http://www.translatorscafe.com/cafe/tools.asp?pn=currency>

United States:

- Top US Exports to the World
http://www.worldsrichestcountries.com/top_us_exports.html

United Kingdom:

- UK export and import in 2009: top products and trading partners
<http://www.guardian.co.uk/news/datablog/2010/feb/24/uk-trade-exports-imports>

Canada:

- The Top 5 Canadian Exports to the U.S.
<http://www.top5ofanything.com/index.php?h=1001a7c3>

Australia:

- Top Australian Commodity Exports
<http://seekingalpha.com/article/149673-top-australian-commodity-exports>
- Australia's top 10 two-way trading partners and Australia's top 10 exports, goods & services
http://www.dfat.gov.au/trade/focus/081201_top10_twoway_exports.html

WORKSHOP ACTIVITY: ENGLISH LANGUAGE - LOCAL VARIATIONS

General:

- List of countries by English-speaking population
http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_countries_by_English-speaking_population
- A Canadian, American, Australian, and a Brit
<http://www.youtube.com/watch?v=qz658-9ZOCc>

- How to understand the differences between British and American English
<http://www.youtube.com/watch?v=GwbpY4eNOgE>
- American vs. British English
<http://www.youtube.com/watch?v=w4YLjF0M9hQ&feature=related>
- Spelling Differences
<http://us2uk.tripod.com/spelling.htm>
- Slang
<http://us2uk.tripod.com/slang.htm>

United States:

- American Slang Greetings
<http://www.schandlbooks.com/AmericanSlangGreetings.html>
- Commonly-Used American Slang
<http://www.manythings.org/slang/slang1.html>

United Kingdom:

- How to understand the difference between the UK and Great Britain
<http://www.youtube.com/watch?v=WyNb2qDrRLM&feature=related>

Canada:

- Canada, Please
http://www.youtube.com/watch?v=cO1bO_NI2jA&feature=related
- Languages in Canada
<http://www.cbc.ca/news/interactives/map-languages-canada/>
- Canada Sightseeing Guide
<http://www.timeforkids.com/TFK/teachers/aw/wr/article/0,28138,537732,00.html>

Australia:

- Australian Slang
<http://www.famie.com/australia/australianslang2.htm>
- Speaking Australian Slang
<http://alldownunder.com/australian-slang/index.html>
- Australian slang - a story of Australian English
<http://australia.gov.au/about-australia/australian-story/austn-slang>
- How to Interpret Australian Slang
http://www.ehow.com/how_4480490_interpret-australian-slang.html

WORKSHOP ACTIVITY: ENGLISH LANGUAGE CUISINE

United States:

- 10 foods that make America great

<http://today.msnbc.msn.com/id/8392312/ns/today-food/t/foods-make-america-great/>

United Kingdom:

- British food

<http://www.slideshare.net/polonaoblak40/british-food-2-presentation>

Canada:

- 10 Must-Try Canadian Foods

<http://www.bakpakguide.com/canada/canada101/highlights/10-must-try-canadian-foods.shtml>

Australia:

- Top Ten Australian Foods

<http://hubpages.com/hub/TopTenAustralianRecipes>

WORKSHOP ACTIVITY: ENGLISH LANGUAGE SPORTS & ENTERTAINMENT

General:

- Top 100 Actors

<http://www.yourbest100.com/2011/03/top-100-actors/>

United States:

- The 50 highest-earning American athletes

<http://sportsillustrated.cnn.com/specials/fortunate50-2010/index.html>

- Greatest U.S. women's sport moments

<http://espn.go.com/page2/s/list/readers/uswomen/moments.html>

- Top 10 Thursday: The Real Top 10 American Entertainers

http://blogs.browardpalmbeach.com/countygrind/2009/07/top_american_entertainers_michael_jackson_elvis_presley_frank_sinatra.php

United Kingdom:

- British sports
<http://www.slideshare.net/atexidoca1/british-sports-cm>
- Ten great sporting moments
<http://www.dailymail.co.uk/sport/article-117077/Ten-great-sporting-moments.html>
- David Beckham, Peter Kay, Winston Churchill and the Best of Brits lists
<http://www.mirror.co.uk/celebs/news/2011/04/08/david-beckham-peter-kay-winston-churchill-and-the-best-of-brits-lists-115875-23045567/>

Canada:

- Canadian sports
http://www.filibustercartoons.com/canguide_2_symbols_sports.php
- Famous Canadian Entertainers
http://www.haltonlinks.com/cdn_entertainers.html

Australia:

- Culture of Australia
http://en.wikipedia.org/wiki/Culture_of_Australia#Sport
- Sporting Greats
<http://australia.gov.au/about-australia/australian-story/sporting-greats>
- Famous Australians
<http://australian.lifetips.com/cat/12035/famous-australians/index.html>

